

Marrëveshje për Kycje
Për Sistemin e Transmisionit të Kosovës¹

Nga dhe ndërmjet
Operator Sistemi, Transmisioni Dhe Tregu – KOSTT, SH.A.
dhe
ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.
Në lidhje me Stabilimentin TCKR

¹ Kjo marrëveshje është përkthyer nga origjinali në Anglisht

PASQYRA E PËRMBAJTJES

Paragrafi 1.	Përkufizimet dhe interpretimet.....	2
Paragrafi 2.	Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje.	10
Paragrafi 3.	Korniza kohore.	10
Paragrafi 4.	Kërkesat tokësore; Qasja në Lokacion.	11
Paragrafi 5.	Ofrimi i të dhënave.	12
Paragrafi 6.	Pajisjet e Njehsimit	13
Paragrafi 7.	Ndryshim/plotësimi i Kontratës.	14
Paragrafi 8.	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.	14
Paragrafi 9.	Shkëputja e Marrëveshjes.	14
Paragrafi 10.	Forca madhore.	16
Paragrafi 11.	Dispozitat e përgjithshme.....	16
Paragrafi 12.	Planifikimi dhe pëlqimet; Kostoja Inxhinierike.	19
Paragrafi 13.	Asetet e Reja të Transmisionit që do ndërtohen nga Gjeneratori.	20
Paragrafi 14.	Rimbursimi për disa Kosto të Aseteve të Përforcimit Infrastruktural.	26
Paragrafi 15.	Termocentrali Hyn në Funkcion.....	26
Paragrafi 16.	Pika e Kycjes dhe Asetet e Transmisionit.	26
Paragrafi 17.	Zhvillimi i Ardhshëm i Sistemit.....	26
Paragrafi 18.	Kapaciteti i Kycjes.....	27
Paragrafi 19.	Të Drejtat e Kycjes.	27
Paragrafi 20.	Kalkulimi dhe pagesa e Ngarkesës për Përdorimin e Sistemit të Transmisionit, Ngarkesës për Operim të Sistemit, si dhe Ngarkesës për Operim të Tregut.	28
Paragrafi 21.	Autorizimi.....	30
Shtojca A	Asetet e Kycjes dhe Asetet e Përforcimit Infrastruktural që duhen ndërtuar apo modifikuar.	31
Shtojca B	Të dhënat teknike.....	33
Shtojca C	Kustet teknike specifike të Pikës së Kycjes	37
Shtojca D	Kapaciteti i Kycjes	39
Shtojca E	Ngarkesat (pagesat).....	40
Shtojca F	Përgjegjësia për Lokacionin e Kycjes.....	41
Shtojca G	Aplikimi për Kycje.....	42

Palët

Kjo Marrëveshje për Kyçje (“**Marrëveshje**”) lidhet më 19 shkurt 2018 (“**Data e ekzekutimit**”) nga dhe ndërmjet

1. Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregu i Kosovës (“**KOSTT**”) në rr. Isa Boletini Nr. 39, 10000 Prishtinë, Kosovë, me numër të regjistrimit të biznesit 70325350, dhe
2. ContourGlobal Terra 6 S.à r.l. (“**Gjeneratori**”), shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar (*société à responsabilité limitée*) organizuar në kuadër të ligjeve të Dukatës së Madhe të Luksemburgut, me zyrën e regjistruar në adresën 35-37 Avenue de la Liberté, L-1931 Luxembourg, Dukata e Madhe e Luksemburgut, si dhe regjistruar në Regjistrin e Tregtisë dhe Kompanive të Luksemburgut, me numrin B 195.738.

bashkërisht të përmendura si “**Palët**” dhe ndaras si “**Palë**”.

Ndërsa, Qeveria e Kosovës synon si çështje politikash të përfshijë sektorin privat në një projekt infrastrukturë të njohur botërisht si “**Projekti Kosova e Re**”;

Në anën tjetër, si pjesë e Projektit Kosova e Re, Gjeneratori do të ndërtojë termocentralin (“**Termocentrali**”) njohur si Stabilimenti TCKR;

Në anën tjetër, sipas Metodologjisë së Tarifimit të Kyçjes në Transmision si dhe Kodit të Rrjetit, gjeneratori që kyçet në Sistemin e Transmisionit mund të zgjedhë të ndërtojë stabilimentet e kyçjes apo t’i mundësojë KOSTT-it të ndërtojë stabilimentet e kyçjes;

Ndërsa, Gjeneratori mëton të formojë një subjekt të ri të organizuar sipas ligjeve të Kosovës (“**CG Kosova**”), si dhe pas formimit të CG Kosova, Gjeneratori synon t’ia bartë të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat tek ajo, si dhe t’ia delegojë të gjitha obligimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje tek CG Kosova, ndërsa KOSTT-i pranon dhe pajtohet me atë caktim;

Ndërsa, Gjeneratori ka dorëzuar Kërkesën për Kyçje para Datës së Ekzekutimit, në formën e Appendix G;

Ndërsa, si pjesë e Projektit Kosova e Re, Gjeneratori duhet të ndërtojë Asetet e Kyçjes të Gjeneratorit (sipas definicionit tek Section 1) si dhe të mbajë në pronësi dhe të mirëmbajë Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit, si dhe Gjeneratori do të ndërtojë, ndërsa KOSTT-i do të mbajë në pronësi dhe të mirëmbajë, Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Asetet e Përforcimit të Infrastrukturës (të definuara me Section 1);

Ndërsa, Gjeneratori mëton të kyçë Termocentralin dhe të ketë qasje në Sistemin e Transmisionit me anë të këtyre aseteve të transmisionit; si dhe

Ndërsa, KOSTT-i pajtohet të kyçë Termocentralin dhe t’i ofrojë Gjeneratorit qasje në Sistemin e Transmisionit të cilin e operon në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Marrëdhënia mes Palëve rregullohet me këtë Marrëveshje.

PJESA 1

Section 1. Përkufizimet dhe interpretimet.

Ashtu siç përdoren në këtë Marrëveshje, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht, apo është e dukshme në kontekst, termat vijues do të kenë kuptimet vijuese; njëjësi (aty ku paraqitet) përfshin edhe shumësin dhe e kundërta; Referimi ndaj Personave përfshin edhe pasardhësit e lejuar të atij Personi, si dhe emëron por, nëse vlen, vetëm nëse ata pasardhës dhe të emëruar nuk janë të ndaluar me këtë Marrëveshje, si dhe referimi ndaj një Personi në cilësi të caktuar përjashton atë Person në ndonjë cilësi tjetër, apo individuale; referimi ndaj Shtojcave, anekseve dhe paragrafëve nënkupton Shtojcë, aneks dhe paragraf i kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse parashihet qartësisht ndryshe. Të gjitha referencat në këtë Marrëveshje ndaj ligjeve, dokumenteve, instrumenteve apo marrëveshjeve konsiderohen të jenë referenca edhe ndaj anekseve, shtojcave, skemave apo ndryshimeve të tyre.

Degë vartëse	ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Marrëveshja	ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.
Periudha e vlefshme e Sanimit nga Pala Homologe	Periudha e vlefshme për sanimin e Rastit të Shkeljes nga KOSTT-i sipas kësaj Marrëveshjeje, siç parashihet me këtë Marrëveshje.
Standardet e zbatueshme	ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
CG Kosova	ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.
Aplikimi për Kyçje	Kërkesa e dorëzuar nga Gjeneratori për kyçje të re apo rritje të kapacitetit të kyçjes ekzistuese në Sistemin e Transmisionit.
Asetet e Kyçjes	Ato asete që lidhin Termocentralin me Sistemin e Transmisionit, asete që përfshijnë, kolektivisht, Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit dhe Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it.
Kapaciteti i Kyçjes	Kapaciteti elektrik i matur me MW, i cili ofrohet në Pikën e Kyçjes, siç paraqitet tek Appendix D.
Pagesa e Kyçjes	Pagesat që ngarkohen nga KOSTT-i për palët që kyçen në Sistemin e Transmisionit të Kosovës, në pajtim me Metodologjinë e KOSTT-it për Pagesat e Kyçjes në Transmision.
Kodi i Kyçjeve	DO të thotë Kapitulli 4 i Kodit të Rrjetit.
Data e Kyçjes	Data në të cilën Asetet e Kyçjes lidhen me Sistemin e Transmisionit, si dhe komisionohen, ndërsa KOSTT-i është në gjendje të ofrojë Kapacitetin e Kyçjes.
E Drejta e Avancimit të Kyçjes	ka kuptimin e dhënë në Section 4.4.
Pika e Kyçjes	Do të thotë pika në lokacionin e Termocentralit, siç specifikohet tek Appendix B, ku Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit lidhen me Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it.
Kontratat e Ndërtimit/Mirëmbajtjes	Kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Paneli i Ndërtimit	ka kuptimin e dhënë në Section 13.5.

Data e Fillimit të Ndërtimit	ka kuptimin e dhënë në Section 12.7.
Kontraktorët	Kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Dita	Periudhë prej njëzet e katër (24) orësh, me fillim në orën 00:00 të secilës ditë.
Norma e Pagesës së vonuara	Euribor plus pesë për qind (5%) në vit, me kalkulim çdo gjashtë muaj, kalkuluar për numrin e saktë të Ditëve për të cilat shuma relevante mbetet e papaguar.
Të dhënat e Detajuara të Planifikimit	Nënkuptojnë të dhënat e nevojshme në pajtim me Aneksin 2 të Kodit të Planifikimit.
Data Efektive	ka kuptimin e dhënë në Section 3.1.
Kodi i Pajisjeve Elektrike	Do të thotë kodi teknik i KOSTT-it që përcakton kriteret për pajisje, që janë pjesë e rrjetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, si dhe për pajisjet e përdoruesve të sistemit në pikën e lidhjes me rrjetin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit.
Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE)	Është trupi i pavarur rregullator i themeluar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, nr. 05/L-084.
Kostoja Inxhinierike	Do të thotë tarifa e paraparë me Appendix E, e cila duhet të jetë në përputhje me Metodologjinë e Pagesave të Kycjes së Transmisionit.
Gjendja Mjedisore/Arkeologjike	Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Euribor	Norma e ofrimit ndërbankar e Federatës Bankare Evropiane efektive në atë moment për depozitat në euro për periudhë të barabartë me tre (3) muaj, që paraqitet në faqen përkatëse të shërbimit Reuter, ose në orën 11 paradite të Kohës së Evropës Qendrore, apo në rast se shërbimi apo ndonjë pasardhës i tij, nuk ofron më informata të tilla, shërbimi tjetër sipas pajtimit të Palëve, që ofron normë të krahasueshme.
Euro ose €	Valuta e vetme e shteteve anëtare pjesëmarrëse të Bashkimit Evropian.
Data e Ekzekutimit	ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.
Dokumentet e Financimit	Kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Forca madhore	ka kuptimin e dhënë në Section 10.
GenCo	Do të thotë Gjeneratori.
Kontraktor i GenCo-s	Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Gjeneratori	ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

Rasti i Bankrotimit të Gjeneratorit	Emërimi i kujdestarit, administratorit, trustit, apo likuiduesit të Gjeneratorit, ose të gjitha apo thelbësisht të gjitha asetete të Gjeneratorit, në ndonjë procedurë të nisur nga, sipas rastit, ose emërimi i kujdestarit, administratorit, trustit, apo likuiduesit të tillë në ndonjë procedurë të iniciuar kundër Gjeneratorit, që nuk shkarkohet brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh pas atij emërimi, ose nëse Gjeneratori jep pëlqimin apo pranon në heshtje atë emërim.
Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit	Stabilimentet dhe pajisjet e projektuara, ndërtuara apo instaluara nga Gjeneratori apo në anën e Pikës së Kyçjes të Gjeneratorit, për qëllimet e Kyçjes së Termocentralit me Pikën e Kyçjes, siç identifikohet tek Appendix A.
Rasti i Shkeljes nga Gjeneratori	ka kuptimin e dhënë në Section 9.2.
Kapaciteti Importues i Gjeneratorit	Ka kuptimin e specifikuar për të tek Appendix D.
Pala e Gjeneratorit	Aksionar, drejtor, zyrtar, punëtor, Kontraktor i GenCo-s, përfaqësues, agjent, anëtar, menaxher apo Degë (I Afërt) e Gjeneratorit.
QEK	Republika e Kosovës, duke vepruar përmes Qeverisë së Kosovës.
Garanci Qeveritare	Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Implementimit.
Kodi i Rrjetit	Ka kuptimin sipas definicionit të Ligjit për Energji Elektrike, 2016.
Marrëveshja e Implementimit	Marrëveshja me këtë emër ndërmjet QEK-së dhe GenCo-s, e datës apo përreth Datës së Ekzekutimit, në lidhje me Projektin Kosova e Re.
Pranimi i Zhdëmtimit	ka kuptimin e dhënë në Section 13.18(a)(iii).
Njoftimi për Zhdëmtim	ka kuptimin e dhënë në Section 13.18(a)(i).
Asetet Infrastrukturore	Nënkuptojnë asetet e transmisionit që përdoren dhe ndahen nga të gjithë Përdoruesit e Sistemit të Transmisionit. Për shmangie të dyshimeve, çdo transformator energjie në nën-stacion që zgjerohet/ndërtohet nga Gjeneratori do të jetë Aset i Kyçjes së Gjeneratorit, e jo Aset Infrastrukturor.
Asetet e Përforcimit Infrastrukturor	Nënkuptojnë përmirësimet e kryera në Asetet Infrastrukturore, duke përfshirë avancimet apo modifikimet tjera në Asetet Infrastrukturore ekzistuese, si dhe ndërtimin e Aseteve të reja Infrastrukturore, siç identifikohen tek Appendix A.
Qarku i Interkoneksionit	Çdo qark që është pronë pjesërisht e KOSTT-it dhe pjesërisht e Gjeneratorit.
Kosova	Republika e Kosovës.
Projekti Kosova e Re	Ka kuptimin e dhënë në recitale.

KOSTT	Do të thotë “OPERATORI I SISTEMIT, TRANSMISIONIT DHE TREGUT” - KOSTT” Sh.A., shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrën kryesore në Rr. Isa Boletini nr. 39, 10000 Prishtinë, Kosovë, me numër të regjistrimit të biznesit 70325350.
Rasti i Bankrotimit të KOSTT-it	Emërimi i kujdestarit, administratorit, trustit, apo likuiduesit të KOSTT-it, ose të gjitha apo thelbësisht të gjitha asetëve të KOSTT-it, në ndonjë procedurë të nisur nga KOSTT, sipas rastit, ose emërimi i kujdestarit, administratorit, trustit, apo likuiduesit të tillë në ndonjë procedurë të iniciuar kundër KOSTT-it, që nuk shkarkohet brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh pas atij emërimi, ose nëse KOSTT-it jep pëlqimin apo pranon në heshtje atë emërim.
E Drejta e Kalimit e Marrëveshje për Kyçje të KOSTT-it	ka kuptimin e dhënë në Section 4.3.
Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it	Stabilimentet dhe pajisjet që duhen projektuar, ndërtuar apo instaluar në anën e KOSTT-it të Pikës së Kyçjes për të mundësuar lidhjen e Stabilimentit nga Pika e Kyçjes deri tek pjesa tjetër e Sistemit të Transmisionit, siç identifikohet tek Appendix A, duke përfshirë pa kufizim pajisjet e tele-njehsimit, linjat e transmisionit dhe pajisjet përcjellëse, transformatorët dhe pajisjet përcjellëse, reletë dhe pajisjet këmbyses, mjetet e telekomunikimit, tele-njehsimit si dhe interfejsi për sistemin SCADA, pajisjet mbrojtëse dhe pajisjet e sigurisë.
Rasti i Shkeljes nga KOSTT	ka kuptimin e dhënë në Section 9.2.
Palë e KOSTT-it	Aksionar, drejtor, zyrtar, punëtor, Kontraktor, përfaqësues, agjent, anëtar, menaxher apo Degë (I Afërt) e KOSTT-it.
Riorganizim apo Privatizim i KOSTT-it	Cilado prej këtyre: <ul style="list-style-type: none"> (a) Riorganizimi i KOSTT-it, ashtu që operacionet e kyçjes së KOSTT-it barten tek një Ndërmarrje të ndarë Publike; (b) Transferimi i aksioneve të KOSTT-it nga QEK tek një Person që nuk është Autoritet Publik, ashtu që KOSTT-i nuk kualifikohet më si Ndërmarrje Publike, ose shitja nga KOSTT-i e të gjitha apo thelbësisht të gjitha asetëve të KOSTT-it tek Pasardhësi i Licencuar i KOSTT-it, ose ngjarja e një transaksioni të ngjashëm që rezulton me gjendjen ku Pasardhësi i Licencuar i KOSTT-it merr përsipër detyrimin e KOSTT-it për të ofruar kyçjet në Sistemin e Transmisionit në Kosovë; ose (c) Ngjarja e ndryshimit të ligjeve në Kosovë që ka për efekt lirim të KOSTT-it nga detyrimi për të bërë lidhjet me Sistemin e Transmisionit në Kosovë, si dhe caktimi i atij detyrimi tek një Pasardhës i Licencuar i KOSTT-it.
Stabilimenti TCKR	ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

Ligjet e Kosovës	Ligjet e Kosovës, si dhe të gjitha statutet, traktatet, kodet, urdhëresat, urdhrat, rregullat, rregulloret, urdhrat ekzekutivë, vendimet gjyqësore, njoftimet, vendimet, rregulloret dhe aktet nënligjore, apo aktet tjera të ngjashme të lëshuara nga cilido Autoritet Publik në bazë të këtyre, në çdo rast, që vlejnë për Palët, Projektin Kosova e Re, apo në lidhje me Marrëveshje të Projektit, Dokument Financimi, apo Kontratë Ndërtimi/Mirëmbajtje, bashkë me të gjitha ndryshimet, plotësimet, zëvendësimet, riinterpretimet, apo ndryshe modifikimet e tyre nga Autoritetet Publike të Kosovës, kohë pas kohe.
Pasardhësi i Licencuar i KOSTT-it	Person që licencohet sipas ligjeve të Kosovës për të ushtruar funksionet e rrjetit në sektorin e energjisë elektrike të Kosovës.
Humbjet	çdo humbje, dëmtim, përgjegjësi, pagesë apo obligim (duke përjashtuar humbjet, dëmtimet, përgjegjësinë, pagesën apo obligimet indirekte apo pasuese, përveç në rast se kjo lind nga ndonjë neglizhencë e rëndë ose kundërvajtje e qëllimshme e Palës zhdëmtuese) si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet (përfshirë tarifat ligjore të arsyeshme) në lidhje me to.
Operatori i Tregut	Nënkupton personin juridik të zgjedhur, e pastaj të licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, për të operuar tregun e organizuar të energjisë elektrike. Ky është njëri prej funksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit.
Rregullat e Tregut	Do të thotë rregullat e tregut të përgatitura nga KOSTT dhe miratuar nga ZRRE, në fuqi në Datën e Ekzekutimit, gjenden tek http://www.kostt.com/website/images/stories/PO-MO-001-The_market_rules_transition_1.pdf , ose ndonjë kod, rregull, apo instrumente të ngjashme që rregullojnë funksionimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, të cilat Palët pajtohen që nuk vlen për GenCo-n apo Projektin Kosova e Re, sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndonjërin prej Marrëveshjeve të Projektit.

Efekt Material mbi GenCo-n	<p>Efekt material dhe negativ mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) GenCo-n apo zotësinë e saj për të përmbushur detyrimet apo ushtruar të drejtat apo për të realizuar beneficionet e plota (ekonomike apo të tjera) sipas Marrëveshjeve të Projektit, Kontratës së Ndërtimit/Mirëmbajtjes, apo Dokumentit të Financimit; (b) Zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, përdorimin, operimin, mirëmbajtjen, apo performancën e Stabilimentit TCKR; (c) Interesat e Kompanisë Holding Sponsore apo Sponsorit Ultimativ (të perkufizuar në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë) ose kthimin e apo mbi investimet e tyre në lidhje me pjesëmarrjen e GenCo-s në Projektin Kosova e Re; (d) Zotësinë e cilësdo palë homologe në Marrëveshje të Projektit, Kontratë të Ndërtimit/Mirëmbajtjes, apo Dokument të Financimit për të përmbushur detyrimet e saj sipas tyre.
Kodi i Njehsimit	Kodi i përgatitur nga OSTT në bazë të Ligjit për Energjinë Elektrike; për të shmangur hutinë, ky nuk i referohet Kodit të njehsimit të Distribucionit.
Të Dhënat e Njehsimit	Leximet e njehsorëve që i jepen Operatorit të Tregut nga Sistemi i Njehsimit nga Pala relevante.
Pajisjet e Njehsimit	Pajisjet dhe instalimet në Sistemin e Njehsimit sipas specifikimit në Kodin e Njehsimit që mjaftojnë të ofrojnë Të Dhënat e Njehsimit sipas Rregullave të Tregut.
Sistemi i Njehsimit	Grumbullimi i regjistruar i njehsorëve që trajtohet si instalim i vetëm që ofron lexim të vetëm apo grup të përafërt të leximeve për një Vendbanim.
Metodologjia e Pagesave të OT-së	Do të thotë metodologjia e përgatitur nga KOSTT si dhe miratuar nga ZRRE-ja për të përcaktuar tarifat dhe ngarkesat që duhen paguar nga Përdoruesit për shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit, si dhe specifikisht tarifat dhe ngarkesat për Operatorin e Tregut.
Vlera Moderne Ekuivalente e Aseteve (MEAV)	Kostoja rrjedhëse e zëvendësimit të asetit të transmisionit. Kjo përdoret në kalkulimin e pagesave të operimit dhe mirëmbajtjes.
MW	Njësi e kapacitetit të gjenerimit elektrik e barabartë me 1 megavat elektrike apo 1,000,000 vatë elektrike.
OeM	Do të thotë operim dhe mirëmbajtje.
Kodi i Planifikimit Operativ	Do të thotë Kapitulli 5 i Kodit të Rrjetit.
Kodi Operacional	Do të thotë Kapitulli 7 i Kodit të Rrjetit.
Palë apo Palët	Kanë kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

Person	Çdo individ, korporatë, partneritet, sipërmarrje e përbashkët, asociacion, trust afarist, organizatë e pakorporatizuar, Autoritet publik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, apo entitet tjetër.
Barrët e Lejuara	ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Kodi i Planifikimit	Do të thotë Kapitulli 3 i Kodit të Rrjetit.
Marrëveshja për Blerjen e Energjisë	Do të thotë marrëveshje për blerjen e energjisë për Projektin Kosova e Re ndërmjet NKEC-së dhe Gjeneratorit, me datë apo përreth datës së këtushme.
Termocentral	Ka kuptimin e dhënë në recitale.
Të dhënat Preliminare të Planifikimit të Projektit	Nënkuptojnë të dhënat e nevojshme në pajtim me nenin 8 të Kodit të Planifikimit.
Udhërrëfyesi i Prokurimit	Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Marrëveshjet e Projektit	Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Implementimit.
Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes	Ato praktika, metoda e procedura që janë në përputhje me kriteret e sigurisë dhe ato ligjore, të cilat realizohen me zbatimin e një shkalle të aftësisë, vigjilencës, kujdesit dhe parashikimit nga një gjenerator i aftë dhe me përvojë i energjisë elektrike apo që angazhohet në të njëjtin apo lloj të ngjashëm të sipërmarrjes apo aktivitetit me të njëjtat apo rrethana e kushte të ngjashme me ato që zotërojnë në Kosovë, si dhe që përmbushin standardet e shëndetit, sigurisë dhe ato mjedisore të kompanive ndërkombëtare shërbyese me reputacion të lartë. Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes nuk kufizohen në praktika optimale, metoda apo akte në përjashtim të të tjerave, por janë një spektër i praktikave, metodave e akteve të mundshme që mund të priten të arrijnë rezultatin e dëshiruar me kosto të arsyeshme, në përputhje me besueshmërinë dhe sigurinë.
Autoriteti publik	secili prej këtyre në vijim me juridiksion mbi GenCo-n, KOSTT-in, Projektin Kosova e Re, apo ndonjë pjesë të tyre: <ul style="list-style-type: none"> (a) QEK, apo ndonjë pjesë vartëse e saj, apo ndonjë autoritet lokal qeveritar; (b) Secili departament, autoritet, instrument, agjenci, apo organ gjyqësor i cilitdo Autoritet Publik përshkruar në paragrafin (a) si më lart; (c) Gjykatat dhe tribunalet në Kosovë; (d) Secila agjenci e pavarur rregullative me juridiksion mbi GenCo-n, KOSTT-in, Projektin Kosova e Re, apo ndonjë pjesë të tyre; ose (e) Çdo autoritet, departament, organ, zyrë, instrument, komision, korporatë, degë, drejtori, agjenci, ministri, gjykata, tribunale, autoritete gjyqësore, organe legjislativë, organe administrative, organe rregullative, entitete autonome apo kuazi-autonome apo

autoritete tatimi të nivelit shtetëror, qytetit, krahinës, komunës, lokale apo rajonale, apo departament, komunë apo ndonjë ndarje politike vartëse e tyre, duke përfshirë por pa u kufizuar në të, secilin Person (autonom apo jo) që ushtron funksione ekzekutive, legislative, gjyqësore, rregullative apo administrative, të apo që lidhen me ndonjërin prej entiteteve të lartpërmendura.

Ndërmarrje Publike	“ndërmarrje publike”, përkufizuar sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike, 2008, ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrje Publike (nr. 05/L-009).
Lokacioni	ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Marrëveshja për Bartjen e Lokacionit	Marrëveshja me emër të njëjtë ndërmjet Gjenerimit të KEK-ut (sipas definicionit në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë) si dhe GenCo-s, me datë apo përreth Datës së Ekzekutimit.
Barazimi	Emri kolektiv për proceset që përdoren për përcaktimin e shfrytëzimit të sistemit nga secila Palë dhe detyrimet financiare si dhe pagesat vijuese që nxirren nga kjo, siç parashihet me Rregullat e Tregut.
Njoftimi i Posaçëm i Shkeljes nga QEK-ja	ka kuptimin e dhënë në Section 9.3.
Metodologjia e Pagesave të OS-së	Do të thotë metodologjia e përgatitur nga KOSTT si dhe miratuar nga ZRRE-ja për të përcaktuar tarifat dhe ngarkesat që duhen paguar nga Përdoruesit për shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit, si dhe specifikisht tarifat dhe ngarkesat për Operatorin e Sistemit (OS).
Të dhënat Standarde të Planifikimit	Nënkuptojnë të dhënat e nevojshme në pajtim me Aneksin 1 të Kodit të Planifikimit.
Operatori i Sistemit (OS)	Departamenti brenda OSTT-së që është përgjegjës për operimin e sistemit të transmisionit, duke përfshirë dispeçingun ekonomik, sigurinë e sistemit të Transmisionit dhe cilësinë e furnizimit.
Tenderi (Impianti)	Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.
Data e Bartjes	ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Bartjen e Lokacionit.
Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Transmision	Metodologjia e hartuar nga KOSTT-i për përcaktimin e Pagesave të Kyçjes, miratuar nga ZRRE-ja.
Sistemi i Transmisionit	Nënkupton rrjetin elektrik të tensionit të lartë, në pronësi dhe operuar nga KOSTT, siç parashihet me Ligjin për Energji Elektrike 05/L-085.
Operatori i Sistemit të Transmisionit	Person fizik apo juridik përgjegjës për operimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmisionit si dhe zhvillimin e rrjetit të transmisionit, si dhe aty ku vlen, interkoneksionit të tij me rrjetet tjera, si dhe sigurimin e besueshmërisë afatgjate të rrjetit në përballje me kërkesat për transmisionin e energjisë elektrike.

Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit	Do të thotë licencë e lëshuar nga ZRRE për Operatorin e Sistemit të Transmisionit, duke përcaktuar kështu të drejtat dhe detyrimet e të licencuarit në lidhje me Sistemin e Transmisionit, në pronësi, operuar dhe mirëmbajtur nga Operatori i Sistemit të Transmisionit.
Ngarkesa për Përdorimin e Sistemit të Transmisionit, Ngarkesa për Operim të Sistemit, si dhe Ngarkesa për Operim të Tregut	Nënkuptojnë respektivisht, shpenzimet mujore dhe/ose vjetore për përdorimin e Rrjetit, Operimin e Sistemit dhe Operimin e Tregut, të ngarkuara nga KOSTT-i për palët që shfrytëzojnë Sistemin e Transmisionit, si dhe në përputhje me Metodologjinë e Pagesave TNUoS, Metodologjinë e Pagesave të OS-së dhe Metodologjinë e Pagesave të OT-së, si dhe specifikuar me Strukturën e Ngarkesave të nxjerrë nga ZRRE-ja.
Metodologjia e Pagesave të TNUoS-së	Do të thotë metodologjia e përgatitur nga KOSTT si dhe miratuar nga ZRRE-ja për të përcaktuar tarifafat dhe ngarkesat që duhen paguar nga Përdoruesit për shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit, si dhe specifikisht tarifafat dhe ngarkesat për shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUoS).
OSTT	Operatori i sistemit, pronari i rrjetit të transmisionit, si dhe operatori i tregut, siç definohet me Kodin e Rrjetit.
Ngarkesa për Operimin e Sistemit dhe Pasqyra e Ngarkesave për Operim të Tregut	Do të thotë pasqyra formale vjetore e Ngarkesës për Operim të Sistemit si dhe Ngarkesa për Operim të Tregut që KOSTT-i vjel çdo vit nga Përdoruesit, siç miratohet çdo vit nga ZRRE-ja.
Përdoruesit	Do të thotë palët që shfrytëzojnë Sistemin e Transmisionit, duke përfshirë Gjeneratorin.
Të Dhënat e Përdoruesve në Sistem	Nënkuptojnë “Të dhënat e Përdoruesve në Sistem” të kërkuara sipas Appendix B.
Ditë Pune	Do të thotë çdo Ditë tjetër përveç të shtunave, të dielave, si dhe festave zyrtare që normalisht shënohen në Kosovë.

Section 2. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje.

Section 2.1. Gjeneratori mëton që Termocentrali të lidhet me me, si dhe të ketë qasje në, Sistemin e Transmisionit në përputhje me kriteret e Kodit të Rrjetit dhe Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Transmision, kriteret përcjellëse komerciale dhe detyrimet e parapara me Rregullat e Tregut (deri në masën që Gjeneratori merr pjesë në treg), si dhe rregullat tjera të vlefshme, si dhe këtë Marrëveshjeje.

Section 2.2. KOSTT-i pajtohet, sipas kushteve të këtushme, të kyçë Termocentralin me, si dhe t'i ofrojë Gjeneratorit qasje në Sistemin e Transmisionit në përputhje me obligimet përkatëse sipas Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit, Kodin e Rrjetit, Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Transmision, si dhe në respektim të kërkesave dhe detyrimeve komerciale të specifikuar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

Section 3. Korniza kohore.

Section 3.1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe efekt në datën më të vonë prej (a) Datës së Ekzekutimit dhe (b) datës në të cilën Marrëveshja për Blerjen e Energjisë bëhet efektive në pajtim me Paragrafin 2.1 (*Efektshmëria; Kohëzgjatja*) të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (ku ajo datë e

efektshmërisë është “**Data Efektive**”), si dhe mbetet në fuqi deri në ndonjë ndryshim relevant në rrethana, siç identifikohet tek Section 9.

Section 3.2. Një kornizë indikative kohore për Projektin është dhënë tek Appendix A. Megjithatë, as KOSTT-i e as Gjeneratori nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë vonesë, cilido të jetë shkaku, në këtë kornizë afatesh.

Section 3.3. Të dyja Palët pajtohen që të mbajnë Palën tjetër të informuar për progresin, si dhe në veçanti nëse ka ndonjë ndryshim në kornizën kohore të dhënë tek Appendix A.

Section 4. Kërkesat tokësore; Qasja në Lokacion.

Section 4.1. Kërkesat tokësore për ndërtimin e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural do të përcaktohen tek Appendix A pas përfundimit të studimeve të përshkruara tek Section 13.1 si dhe përcaktimin e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural që duhen kryer. Gjeneratori duhet të konsultohet me KOSTT-in pas identifikimit të Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural që duhen kryer si dhe për qëllimet e identifikimit të tokës që është arsyeshëm e domosdoshme për instalimin e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural. Pas atij procesi, Palët do të ndryshojnë e plotësojnë këtë Marrëveshje për të përfshirë Appendix A kërkesat tokësore për Asetet e Kyçjes dhe Asetet e Përforcimit Infrastruktural që duhen ndërtuar nga Gjeneratori. Gjeneratori merr përgjegjësinë për sigurimin e pronësisë apo qiramarrjes afatgjatë, apo të drejtave të krahasueshme tokësore, si dhe Gjeneratori cakton apo ndryshe ia bart të drejtat e tilla KOSTT-it në Datën e Kyçjes në pajtim me Section 13.11.

Section 4.2. Kërkesat tokësore mund të sigurojnë hapësirën për asete plotësuese transmissioni që mund të ndërtohen në të ardhmen në tokën e përmendur tek Appendix A. Në rast se këto asete plotësuese përdoren për të kyçur Përdorues të tjerë, Gjeneratorit i duhet paguar një rabat në pajtim me Metodologjinë e Tarifave të Kyçjes në Transmision apo rregulla të tjera të zbatueshme.

Section 4.3. Gjeneratori me këtë marrëveshje i jep KOSTT-it të drejtë kalimi jo-ekskluziv (“**E Drejta e Kalimit e Marrëveshje për Kyçje të KOSTT-it**”) për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje, ndaj, për, mbi, përtej dhe brenda lokacionit të Termocentralit për përdorim nga KOSTT-i, Kontraktorët e tij, si dhe çdo person të autorizuar nga KOSTT-i, me të gjitha pajisjet dhe makinerinë, që janë nevojshme për pajisjen, zëvendësimin, dekomisionimin, operimin, testimin, inspektimin dhe mirëmbajtjen e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve Infrastruktural, në pajtim me Praktikat e Matura të Ndërmarrjes, si dhe standardet e procedurat në fuqi të Kosovës për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit TL, siç parashihen me Kodin e Rrjetit, Kodin e Njehsimit, si dhe procedurat operative dhe metodologjitë e KOSTT-it në fuqi. Përveç kësaj, Gjenerimi i KEK-ut do t’i ofrojë KOSTT-s të gjitha të drejtat tjera, kalimit, servitutit, licencat, të drejtat e shfrytëzimit, si dhe të drejtat tjera të pronës së paluajtshme që me arsye janë të domosdoshme për qëllimin e tillë. GenCo do të respektojë të gjitha kërkesat e arsyeshme të KOSTT-it, si dhe të ndihmojë në rregullimin, e qasjes së tillë. Të gjithë personat në Stabilimentin TCKR apo Lokacion në emër të KOSTT-it do të respektojnë rregulloret dhe procedurat përgjithësisht në zbatim për sigurinë të GenCo-s dhe Kontraktorëve të GenCo-s në pajtim me Praktikat e Matura të Ndërmarrjeve, Ligjet e Kosovës, si dhe Standardet e zbatueshme që i janë vënë në dispozicion atyre personave, si dhe duhet të respektojnë udhëzimet dhe urdhëresat e GenCo-s dhe Kontraktorëve të GenCo-s, si dhe nuk duhet të shkaktojnë ndonjë ndërhyrje të panevojshme apo edhe pengim të aktivitetëve të GenCo-s apo Kontraktorëve të GenCo-s në Lokacion. Rregulloret dhe procedurat e tilla të sigurisë mund të ndryshojnë kohë pas kohe. Duke mos anashkalluar pikat paraprake, KOSTT-i do të ketë të drejtë të propozojë korrigjime të arsyeshme në rregulloret dhe procedurat e sigurisë si më lart, ndërsa GenCo në masë të arsyeshme duhet të trajtojë ato korrigjime të propozuara.

Section 4.4. KOSTT-i me këtë i jep Gjeneratorit të drejtë kalimi jo-ekskluziv (“**E Drejta e Kalimit për Avancimin e Kyçjes**”) ndaj, për, mbi, përtej dhe brenda pronës së KOSTT-it për përdorim nga Gjeneratori, Kontraktorët e tij, si dhe çdo Person i autorizuar nga Gjeneratori, me të gjitha pajisjet dhe

makinerinë, deri në masën e kufizuar e domosdoshme për Gjeneratorin që të ndërtojë dhe avancojë Asetet e reja të Kyçjes të KOSTT-it si dhe Aseteve të Përforcimit Infrastrukturalor si dhe të përmbushë të gjitha kriteret tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, apo ndonjë Marrëveshje të tjera Projekti, për periudhën para pranimit-dorëzimit të Aseteve të Reja të Kyçjes së KOSTT-it si dhe Aseteve të Përforcimit Infrastrukturalor. KOSTT do të respektojë të gjitha kërkesat e arsyeshme të GenCo-s, si dhe të ndihmojë në rregullimin, e qasjes së tillë. Të gjithë personat në pronën e KOSTT-it në emër të GenCo-s do të respektojnë rregulloret dhe procedurat përgjithësisht në zbatim për sigurinë të KOSTT-it në pajtim me Praktikat e Matura të Ndërmarrjeve, Ligjet e Kosovës, si dhe Standardet e zbatueshme që i janë vënë në dispozicion atyre personave, si dhe duhet të respektojnë udhëzimet dhe urdhëresat e KOSTT-it, si dhe nuk duhet të shkaktojnë ndonjë ndërhyrje të panevojshme apo edhe pengim të aktiviteteve të KOSTT-it në pronën e KOSTT-it. Rregulloret dhe procedurat e tilla të sigurisë mund të ndryshojnë kohë pas kohe. Duke mos anashkaluar pikat paraprake, GenCo do të ketë të drejtë të propozojë korrigjime të arsyeshme në rregulloret dhe procedurat e sigurisë si më lart, ndërsa KOSTT-i në masë të arsyeshme duhet të trajtojë ato korrigjime të propozuara.

Section 4.5. Gjeneratori duhet të sigurojë që Pika e Kyçjes të jetë me rrethojë të sigurt për të shmangur rreziqet e mundshme ndaj publikut të gjerë apo qasjen e personave të paautorizuar. Të dyja palët duhet të sigurojnë që i gjithë personeli, vizitorët dhe Kontraktorët e tyre të ndjekin trajnimet e duhura para se të kenë leje të hyjnë në lokacion.

Section 4.6. Secila Palë duhet të zhdëmtojë dhe të ruajë Palën tjetër nga dëmtimet nga të gjitha Humbjet që Pala tjetër pëson, merr, paguan apo vuan nga apo në lidhje me pretendimet e lëndimeve apo dëmtimeve nga palët e treta që lindin nga ushtrimi i të drejtave të qasjes nga Pala zhdëmtuese të parapara në këtë Section 4. Sa i përket qasjes së KOSTT-it sipas Section 4.3, ky obligim detyron KOSTT-in që të paguajë sigurimet GenCo-s që janë të zbritshme të lidhura me dëmet e shkaktuara nga KOSTT-i në Stabilimentin TCKR në lidhje me shfrytëzimin e të Drejtave të Kalimit për Marrëveshjen për Kyçje të KOSTT-it. Kjo dispozitë shprehimisht mbijeton përtej çdo shpëputjeje apo ndërprerjeje të kësaj Marrëveshjeje.

Section 5. Ofrimi i të dhënave.

Section 5.1. Të dhënat Preliminare të Planifikimit të Projektit (shih Kodin e Planifikimit, neni 8) si dhe të dhënat Standarde të Planifikimit (shih Kodin e Planifikimit, Shtojca 1) janë ofruar nga Gjeneratori në Aplikimin për Kyçje.

Section 5.2. Para Datës së Ekzekutimit, Gjeneratori ka ofruar tërësinë e plotë të Të dhënave të Detajuara të Planifikimit (siç parashihet me Kodin e Planifikimit, Shtojca 2), që është shënuar tek Appendix B. Këto të dhëna paraqesin parametrat e dizajnit të Termocentralit.

Section 5.3. Pas përfundimit të studimeve të identifikuar tek Section 13.1, palët do të ndryshojnë Appendix B për të ofruar të Dhënat e Përdoruesve në Sistem. Këto paraqesin të dhëna në lidhje me Asetet e Kyçjes dhe Asetet e Përforcimit Infrastrukturalor që janë në pronësi të KOSTT-it. Gjeneratori ka ofruar të Dhënat e Përdoruesve në Sistem për Appendix B për Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit.

Section 5.4. Pas kryerjes së komisionimit të Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastrukturalor siç përshkruhet tek Section 13.10, KOSTT-i dhe Gjeneratori do të kompletojnë Appendix B të azhurnuar (kudo që mundet) me vlerat aktuale të matura që zëvendësojnë vlerat e projektimit.

Section 5.5. Para se Gjeneratori të komisionojë Termocentralin, duhet të ofrojë Appendix B të azhurnuar, duke përfshirë (për aq sa është e mundur) vlerat e matura të parametrave teknike të Termocentralit. Komisionimi i Termocentralit nuk duhet të fillojë deri sa Appendix B e rishikuar të jetë kompletuar dhe të jetë dorëzuar tek një përfaqësues i KOSTT-it.

Section 5.6. Në rast të ndonjë ndryshimi në cilëndo prej të dhënave tek Appendix B, duhet të përgatitet Appendix B e rishikuar me përfshirjen e të dhënave të reja.

Section 5.7. Të gjitha ndryshimet tek Appendix B duhen përfshirë në një letër-rishikimi të re, e cila do të ekzekutohet si amandament i kësaj Marrëveshjeje nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy Palëve. Në ekzekutim të këtij dokument, secila Palë merr përsipër që:

- (a) Të dhënat për të cilat është përgjegjëse janë të sakta dhe të plota, si dhe
- (b) Të dhënat e ofruara nga Pala tjetër janë të arsyeshme dhe të plota.

Section 6. Pajisjet e Njehsimit

Section 6.1. Detajet e Pajisjeve të Njehsimit janë dhënë tek Appendix C.

Section 6.2. Dizajnimi, operimi dhe inspektimi i Pajisjeve të Njehsimit si dhe matjet duhen kryer nga KOSTT-i në pajtim me Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Njehsimit për Kosovën. Kriteret e nevojshme të dizajnit janë paraparë tek Appendix C.

Section 6.3. Palët pranojnë që KOSTT-i është i obliguar sipas Ligjeve të Kosovës të instalojë Pajisjet e Njehsimit. Për t'i mundësuar KOSTT-it të përmbushë atë obligim, Gjeneratori vepron si agjent i KOSTT-it në prokurim dhe instalim të Pajisjeve të Njehsimit, si dhe kryen të gjitha modifikimet, ndërrimet apo avancimet e Pajisjeve të Njehsimit sipas pajtimit të Palëve, të gjitha me shpenzime vetëm të Gjeneratorit (duke u pranuar që Gjeneratori do të ketë të drejtë të rimbursojë ato shpenzime në pajtim me Skemën 1 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë). KOSTT-i duhet të testojë dhe komisionojë Pajisjet e Njehsimit, në të cilën kohë kontrolli mbi Sistemin e Njehsimit i bartet KOSTT-it. Gjeneratori ka të drejtë të jetë dëshmitar gjatë testeve të komisionimit në lidhje me Pajisjet e Njehsimit.

Section 6.4. KOSTT-i është përgjegjës dhe mban përgjegjësi për operimin dhe mirëmbajtjen efektive të Pajisjeve të Njehsimit, përveç kur ndonjë avari apo dëmtim shkaktohet nga veprimet e (i) Gjeneratorit, që vepron ose në emër të KOSTT-it si agjent i tij në pajtim me Section 6.3 ose në emër të vetin, ose (ii) të ndonjë pale tjetër që vepron në emër të Gjeneratorit, në të cilin rast, Gjeneratori mban përgjegjësi të plotë për të gjitha shpenzimet.

Section 6.5. Shpenzimet e pësura nga KOSTT-i në kryerjen e aktiviteteve të operimit dhe mirëmbajtjes do të mbulohen nga Gjeneratori me anë të Pagesës për Përdorimin e Sistemit të Transmisionit, Pagesës së Operimit, si dhe Pagesës për Operimin e Tregut, siç specifikohet tek Appendix E (duke u pranuar që shpenzimet e tilla do të paguhen në pajtim me Paragrafin 11.1.1(a) (*Obligimet e Palëve për shpenzimet e transmisionit dhe tarifën e liferimit të pamjaftueshëm; Obligimet e GenCo-s*) të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë).

Section 6.6. Gjeneratori ka të drejtë të instalojë bllombat e veta njehsuese mbi Pajisjet e Njehsimit si dhe pajisjet përcjellëse, si transformatorët e rrymës dhe tensionit, nyjave (degëzimeve, lidhjeve), modemët, rekorderët, etj. Këto bllomba njehsori mund të instalohen paralelisht (në të njëjtat vrima bllombimi) me bllombat e njehsorit nga KOSTT-i.

Section 6.7. Në raste emergjente KOSTT-i ka të drejtë të ndërhyjë në Sistemin e Njehsimit, duke përfshirë në VT (transformatorë tensioni), CT (transformatorë rryme), kutitë përcjellëse të kabllimit dhe njehsimit, pa njoftim apo pa praninë e personelit të Gjeneratorit; *me kusht, megjithatë*, që KOSTT-i të japë njoftimin e tillë paraprak për aq sa është e mundur në lidhje me emergjencën. Në rastet pa emergjencë, KOSTT-i duhet që me shkrim apo me email, t'i japë Gjeneratorit njoftim paraprak prej 2 Ditësh Pune për çfarëdo kërkesë për qasje në Sistemin e Njehsimit, si dhe Gjeneratori mundet të caktojë personel për të qenë dëshmitarë të procesit. Në mungesë të dëshmitarëve nga ana e Gjeneratorit, KOSTT-i ka të drejtë qasjeje në Sistemin e Njehsimit.

Section 6.8. Gjeneratori ka të drejtë të lexojë njehsorët në çdo kohë. Leximi mund të jetë ose manual ose elektronik. Gjeneratori është përgjegjës për shpenzimet (blerja e parë dhe shpenzimet e vazhdueshme) për pajisje (modemë, etj.) të nevojshme për leximin nga largësia të Pajisjeve të Njehsimit, të cilat duhet të jenë në pajtim me Kodin e Njehsimit (duke u pranuar që Gjeneratori ka të drejtë të rimbursojë ato shpenzime në pajtim me Skemën 1 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë).

Section 7. Ndryshim/plotësimi i Kontratës.

Section 7.1. Secila Palë mund të kërkojë ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje, kur:

- (a) Ka një ndryshim të propozuar në shtrirjen e Pikës së Kyçjes nga ajo që është specifikuar tek Appendix B si dhe/ose në Asetet e Kyçjes nga ato që specifikohen tek Appendix A, duke përfshirë edhe ato si pasojë e ndonjë ndryshimi të implementuar në kufirin e kyçjes, si dhe/ose;
- (b) Ka ndryshim të propozuar të Kapacitetit të Kyçjes nga ai që specifikohet tek Appendix D, si dhe/ose;
- (c) Ka ndryshim të propozuar të kushteve specifike teknike të Pikës së Kyçjes nga ato që specifikohen tek Appendix C, si dhe/ose;
- (d) Ka ndryshime të tjera relevante që kërkojnë modifikimin e kësaj Marrëveshjeje.

Section 7.2. Në rastet kur Marrëveshja i nënshtrohet ndryshimit, ajo zëvendësohet me versionin e ri “amandamenti 1”, sipas pajtimit të të dyja Palëve. Ky proces vlen edhe për ndryshimet pasuese (për shembull ndryshimi nga versioni “amandamenti 2” tek versioni “amandamenti 3”).

Section 7.3. Të gjitha ndryshimet ndaj kësaj Marrëveshjeje duhen nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve.

Section 7.4. Procesi bazë është si vijon:

- (a) Para ndryshimit të kësaj Marrëveshjeje, Pala që kërkon ndryshim/plotësimin e Marrëveshjes nxjerr një kërkesë për ndryshim. Amandamenti i ri i shkruar i Marrëveshjes i dërgohet përfaqësuesit të autorizuar të Palës tjetër, duke shfaqur këtu ndryshimet e propozuara.
- (b) Pala tjetër duhet të bëjë përpjekje komercialisht të arsyeshme për të dhënë përgjigje brenda 10 Ditësh Pune. Nëse Pala tjetër pajtohet me ndryshimin e sugjeruar, Përfaqësuesi i autorizuar i asaj Pale duhet të japë nënshkrimin. Kur pajtimi dështon, Palët negociojnë çështjen dhe kundër-propozimi bëhet brenda 10 Ditësh Pune vijuese (pra brenda një periudhe prej 20 Ditësh Pune nga pranimi i kërkesës së parë për ndryshim).
- (c) Nëse Palët nuk arrijnë të gjejnë pajtimin brenda 10 Ditëve të tjera Pune (pra pas periudhës së përgjithshme prej 30 Ditësh Pune prej pranimit të kërkesës së parë për ndryshim), procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve i paraparë me Section 8 hyn në funksion, si dhe kontesti i tillë zgjidhet në pajtim me procedurat për zgjidhjen e kontesteve teknike.

Section 8. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

Section 8.1. Të gjitha kontestet në kuadër të kësaj Marrëveshjeje duhen zgjidhur në pajtim me dispozitat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të parapara tek Neni 22 (*Zgjidhja e mosmarrëveshjeve*) në Marrëveshjen e Implementimit, të cilat janë inkorporuar këtu, *mutatis mutandis*.

Section 9. Shkëputja e Marrëveshjes.

Section 9.1. Gjeneratori mund të shkëpusë këtë Marrëveshje në çdo kohë me njoftim paraprak me shkrim prej një viti për KOSTT-in, në pajtim me dispozitat e Metodologjinë e Tarifave të Kyçjes në Transmission. Akti i tillë i shkëputjes nuk rezulton me përgjegjësi nga KOSTT-i ndaj Gjeneratorit. KOSTT-i nuk do të bartë përgjegjësi për rimbursimin e parave të pashpenzuara ndaj Gjeneratorit.

Section 9.2. Në rastin e dështimit nga Gjeneratori që të përmbushë ndonjë detyrim material të këtushëm ose në Rastin e Bankrotimit të Gjeneratorit (ku secili është “**Rast i Bankrotimit të Gjeneratorit**”), atëherë KOSTT-i mund të shkëpusë këtë Marrëveshje në pajtim me procedurat vijuese: (i) KOSTT-i i dorëzon Gjeneratorit njoftim të shkruar të shkëputjes, ku specifikohen arsyet e shkëputjes së Marrëveshjes; (ii) Gjeneratori pastaj ka 60 ditë pas pranimit nga Gjeneratori të njoftimit të tillë për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të korrigjuar dështimin e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; *me kusht, megjithatë*, që nëse Gjeneratori me përkushtim përpiqet të sanojë shkeljen e tij dhe po arrihet progres i vërejtshëm drejt përmbushjes së atij sanimi, Gjeneratori do të fitojë një periudhë shtesë, që nuk tejkalon 90 ditë, për të kryer atë sanim para se KOSTT-i të mund të ushtrojë të drejtën e tij të shkëputjes së kësaj Marrëveshjeje; si dhe (iii) KOSTT-i mund të shkëpusë këtë Marrëveshje pas periudhës kohore të përshkruar si më lart përveç nëse Gjeneratori korrigjon shkeljen brenda asaj periudhe kohore. Asnjë rast nuk është Rast i Shkeljes nga Gjeneratori nëse është i shkaktuar, tërësisht apo pjesërisht apo në pjesë substanciale nga ndonjë Rast i Shkeljes nga KOSTT-i. Gjeneratori mund të sanojë Rastet e Shkeljes nga Gjeneratori duke mundësuar që Kontraktori i Gjeneratorit të sanojë atë Rast të Shkeljes nga Gjeneratori.

Deri në masën që ndonjë obligim i Gjeneratorit sipas kësaj Marrëveshjeje është gjithashtu obligim i Gjeneratorit sipas cilësdo Marrëveshje tjetër të Projektit, atëherë secili sanim, zgjidhje apo falje e shkeljes së atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit përbën sanim, zgjidhje apo falje sipas asaj Marrëveshjeje nëse KOSTT-i ka pranuar njoftim të arsyeshëm paraprak të atij sanimi, zgjidhjeje apo faljeje të propozuar të atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit dhe ka dështuar të kundërshtojë me arsye atë sanim, zgjidhje apo falje brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Në rastin e dështimit nga KOSTT-i që të përmbushë ndonjë detyrim material të këtushëm ose në Rastin e Bankrotimit të KOSTT-it (ku secili është “**Rast i Bankrotimit të KOSTT-it**”), atëherë Gjeneratori mund të shkëpusë këtë Marrëveshje në pajtim me procedurat vijuese: (i) Gjeneratori i dorëzon KOSTT-it njoftim të shkruar të shkëputjes, ku specifikohen arsyet e shkëputjes së Marrëveshjes; (ii) KOSTT-i pastaj ka 60 ditë pas pranimit nga KOSTT-i të njoftimit të tillë për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të korrigjuar dështimin e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; *me kusht, megjithatë*, që nëse KOSTT-i me përkushtim përpiqet të sanojë shkeljen e tij dhe po arrihet progres i vërejtshëm drejt përmbushjes së atij sanimi, KOSTT-i do të fitojë një periudhë shtesë, që nuk tejkalon 90 ditë, për të kryer atë sanim para se Gjeneratori të mund të ushtrojë të drejtën e tij të shkëputjes së kësaj Marrëveshjeje; si dhe (iii) Gjeneratori mund të shkëpusë këtë Marrëveshje pas periudhës kohore të përshkruar si më lart përveç nëse KOSTT-i korrigjon shkeljen brenda asaj periudhe kohore. Asnjë rast nuk është Rast i Shkeljes nga KOSTT-i nëse është i shkaktuar, tërësisht apo pjesërisht apo në pjesë substanciale nga ndonjë Rast i Shkeljes nga Gjeneratori. KOSTT-i mund të sanojë Rastet e Shkeljes nga KOSTT-i duke mundësuar që Kontraktori i KOSTT-it të sanojë atë Rast të Shkeljes nga KOSTT-i. Duke mos anashkaluar asnjë dispozitë si më lart, dështimi i KOSTT-it për të respektuar, apo ndryshe për të ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me, Standardet e Zbatueshme apo ligjet e Kosovës, nuk do të jetë Rast i shkeljes nga KOSTT-i si dhe nuk do të ketë masa sanuese të asnjë lloji për Gjeneratorin në lidhje me to, përveç dispozitës së Seksionit 19.2(i) e deri tek Seksioni 19.2(k) të Marrëveshjes së Implementimit (si dhe të gjitha dispozitat e ndërlidhura (në të gjitha Marrëveshjet e Projektit), të cilat parashohin të drejtat dhe mjetet juridike të GenCo-s kundrejt Rastit të Shkeljes nga QEK-ja (sipas definimit në Marrëveshjen e Implementimit) ose në aspektin e mbrojtjes për dobi të GenCo-s në lidhje me ndonjë Veprim apo Mosveprim të NP-së së Specifikuar).

Section 9.3. Deri në masën që ndonjë obligim i KOSTT-it sipas kësaj Marrëveshjeje është gjithashtu obligim i KOSTT-it sipas cilësdo Marrëveshje tjetër të Projektit, atëherë secili sanim, zgjidhje apo falje e shkeljes së atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit përbën

sanim, zgjidhje apo falje sipas asaj Marrëveshjeje nëse Gjeneratori ka pranuar njoftim të arsyeshëm paraprak të atij sanimi, zgjidhjeje apo faljeje të propozuar të atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit dhe ka dështuar të kundërshtojë me arsye atë sanim, zgjidhje apo falje brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

Section 9.4. Nëse ngjan Rasti i Shkeljes nga KOSTT-i, Gjeneratori duhet t'i dorëzojë njoftimin (“**Njoftim i Posaçëm i Shkeljes nga QEK**”) për ngjarjen e atij Rasti të Shkeljes nga KOSTT-i për QEK-në në adresën e specifikuar në Marrëveshjen e Implementimit. QEK-ja do të ketë Periudhën e Zbatueshme të Sanimit nga Pala Homologe pas pranimit të Njoftimit të Posaçëm të Shkeljes nga QEK gjatë të cilës duhet të bëhet pagesa ose të ndërmerret veprimi i nevojshëm nga KOSTT-i për sanimin e Rastit të Shkeljes nga KOSTT-it, me të njëjtin efekt sikur ajo pagesë apo veprim të bëhej apo të ndërmerrej nga KOSTT-i.

Section 10. Forca madhore.

Section 10.1. Dispozitat e Forcës Madhore të parapara me Nenin 21 të Marrëveshjes së Implementimit (*Forca Madhore*) janë inkorporuar këtu, *mutatis mutandis*.

Section 11. Dispozitat e përgjithshme.

Section 11.1. Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjet e Shtetit të Nju-Jorkut.

Section 11.2. Kjo Marrëveshje tejkalon dhe shfuqizon të gjitha negociatat, mirëkuptimet e pajtimit paraprake në lidhje me lëndën e këtushme.

Section 11.3. Titujt dhe nëntitujt e kësaj Marrëveshjeje janë vetëm për lehtësim të referimit, si dhe në asnjë mënyrë nuk kufizojnë e as nuk ndikojnë tek kuptimi apo interpretimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Section 11.4. Secili Aneks apo Shtojcë që përmendet këtu si dhe është bashkëngjitur këtu konsiderohet të jetë i inkorporuar brenda kësaj Marrëveshjeje me atë referencë.

Section 11.5. Palët duhet të mbajnë dosje të sakta e të përditësuara me të dhëna e informata që krijohen gjatë përbushjes së detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha dosjet dhe të dhënat e tilla duhen mbajtur për së paku gjashtëdhjetë (60) muaj pas krijimit të dosjes apo të dhënës së tillë si dhe për çdo periudhë tjetër plotësuese që kërkohet nga cilido autoritet me kompetencë mbi cilëndo Palë, si dhe asnjëra Palë nuk mund të hedhë apo shkatërrojë dosjet apo të dhënat e tilla pas periudhës gjashtëdhjetë (60) mujore, përveç nëse Pala që dëshiron të hedhë apo shkatërrojë dosjet apo të dhënat e tilla së pari i jep njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh Palës tjetër, duke përshtuar përgjithësisht dosjet apo të dhënat që do të shkatërrohen apo largohen, si dhe nëse Pala që pranon atë njoftim nuk ka dhënë kundërshtimin me shkrim brenda dhjetë (10) ditësh.

Section 11.6. Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën angleze dhe shqipe, me dy origjinalë për secilën gjuhë; njëri origjinal mbahet nga KOSTT-i ndërsa tjetri nga Gjeneratori. Në rast mospërputhjes, mungese konsistence apo dykuptimësie ndërmjet versionit anglisht dhe atij shqip, versioni në gjuhën angleze mbizotëron. Të gjitha njoftimet, vërtetimet dhe dokumentet e komunikimit tjera (përfshirë kopjet) e dhëna apo të hartuara sipas apo në lidhje me këtë Marrëveshje do të jenë në anglisht.

Section 11.7. Me shkëputjen e kësaj Marrëveshjeje, të gjitha premtimet, obligimet, zotimet dhe garancitë e dhëna me këtë Marrëveshje ndërpriten dhe nuk kanë fuqi apo efekt, si dhe Palët nuk kanë më detyrime apo përgjegjësi sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç atyre detyrimeve dhe përgjegjësi që janë krijuar para dhe mbesin të pandërprera në datën e shkëputjes, si dhe ato detyrime e përgjegjësi që shprehimisht mbijetojnë apo për shkak të natyrës së tyre duhet të mbijetojnë përtej shkëputjes.

Section 11.8. Nga asnjë lloj kundërvajtjeje nga cilado Palë në përmbushje apo respektim të cilësdo dispozite të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të hiqet dorë apo të lihet anash përveç me pëlqimin e shprehur me shkrim të Palës tjetër. Asnjë lloj heqje dorë nga cilado Palë ndaj kundërvajtjes së Palës tjetër në përmbushje apo respektim të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të veprojë e as të merret si heqje dorë nga diçka tjetër apo nga ndonjë kundërvajtje tjetër, të një natyre të ngjashme apo të ndryshme.

Section 11.9. Brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje, Gjeneratori mund t'ia caktojë të drejtat, titujt dhe interesat brenda dhe mbi, si dhe të delegojë obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, CG Kosovës. Për më tepër, Gjeneratori mund t'ia caktojë si kolateral interesat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje një Huadhënësi (sipas definimit në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë) apo ndonjë Personi në lidhje me ushtrimin apo zbatimin e të drejtave të kolateralit nga Huadhënësi (siç definohet në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë). Përveç siç parashihet me këtë Section 11.9, Gjeneratori nuk mund t'ia bartë këtë Marrëveshje ndonjë Personi tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të KOSTT-it. Në pajtim me këtë Section 11.9, kjo Marrëveshje nuk mund të bartet nga KOSTT-i tek asnjë palë tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të Gjeneratorit. Palët marrin në njohuri dhe pajtohen që QEK-ja mund të privatizojë, apo të ndajë nga KOSTT-i, funksionet e kyçjes të KOSTT-it. Pa anashkaluar paragrafin Section 11.9, në rast se ndodh Riorganizimi apo Privatizimi i KOSTT-it, KOSTT-i mund t'ia bartë të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat në dhe nga kjo Marrëveshje Pasardhësit të Licencuar të KOSTT-it nëse (i) QeK pa ndërprerje garanton përmbushjen nga Pasardhësi i Licencuar i KOSTT-it të të njëjtave kushte dhe afate si Garanci e Qeverisë, apo që ai sigurim komercial sigurohet për obligimin e Pasardhësit të Licencuar të KOSTT-it që në gjykimin e arsyeshëm afarist të Gjeneratorit ofron alternativë adekuate ndaj Garancisë Qeveritare, ose sigurimi i tillë komercial jepet për obligimin e Pasardhësit të Licencuar të KOSTT-it, që në gjykimin e arsyeshëm afarist të Gjeneratorit ofron alternativë adekuate ndaj Garancisë Qeveritare, (ii) Pasardhësi i Licencuar i KOSTT-it është arsyeshëm i aftë të përmbushë të gjitha të drejtat dhe obligimet e KOSTT-it sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe (iii) bartja e tillë nuk do të çojë drejt Efektit Material mbi GenCo-n. Pa anashkaluar Section 11.9, në rast se QEK-ja merr përsipër të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat e Gjeneratorit në dhe mbi Stabilimentin TCKR ose (i) me skadimin e afatit të Marrëveshjes së Implementimit sipas Paragrafit 20.6 (*Skadimi i Afatit*) të Marrëveshjes së Implementimit ose (ii) sipas Nenit 20 (*Të drejtat dhe obligimet pas shkëputjes; Kompensimi*) të Marrëveshjes së Implementimit pas shkëputjes së Marrëveshjes së Implementimit, Gjeneratori duhet që deri në masën që parashihet me Marrëveshjen e Implementimit, pa nevojë për pëlqim nga KOSTT-i, QEK-ja apo ndonjë Person tjetër, t'ia bartë të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat në dhe mbi këtë Marrëveshje QEK-së (apo një të caktuari nga QEK-ja, sipas përzgjedhjes në pajtim me kushtet e Marrëveshjes së Implementimit), si dhe pala bartëse do të lirohet nga të gjitha përgjegjësitë apo obligimet sipas kësaj Marrëveshjeje që lindin pas datës së atij caktimi dhe përtërirjeje. Nëse kërkon Gjeneratori, KOSTT-i ekzekuton, bashkë me QEK-në dhe Gjeneratorin, të gjitha marrëveshjet dhe dokumentet e arsyeshme dhe të zakonshme të domosdoshme për të implementuar bartjen dhe ripërtërirjen e kësaj Marrëveshjeje nga dhe pas datës së asaj shkëputjeje. Nëse QEK apo KOSTT-i nuk zbatojnë arsyeshëm këtë Section 11.9, Gjeneratori do të ketë të drejtë të shkëpusë këtë Marrëveshje duke i dorëzuar njoftimin KOSTT-it. Përtërirja e kësaj Marrëveshjeje apo bartja e aseteve nga Gjeneratori sipas këtij Section 11.9 nuk e liron KOSTT-in nga obligimet e veta sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit apo ndonjë Dokumenti për Financim që ekziston në datën e asaj përtërirjeje, transferimi apo caktimi. Në rast se Marrëveshja e implementimit shkëputet dhe QEK blen Stabilimentin TCKR sipas nenit 20 (*Të drejtat dhe obligimet në shkëputje; Kompensimi*) të Marrëveshjes së Implementimit, deri në masën e paraparë me Marrëveshjen e Implementimit, Palët pajtohen që KOSTT-i të ekzekutojë, bashkë me QEK-në dhe Gjeneratorin, të gjitha marrëveshjet dhe dokumentet e

arsyeshme të nevojshme për të implementuar bartjen dhe ripërtërirjen e kësaj Marrëveshjeje nga dhe pas datës së asaj shpëputjes. Kjo Marrëveshjeje obligon dhe vlen për dobi të Palëve dhe çdo pasardhës apo të autorizuar që përfiton një interes sipas kësaj Marrëveshjeje në pajtim me këtë dispozitë. Çdo bartje a caktim në kundërshtim me këtë Section 11.9 do të jetë nul dhe i pavlefshëm.

Section 11.10. Secila Palë ekzekuton të gjitha dokumentet e arsyeshme e të domosdoshme për të vënë në zbatim qëllimet e kësaj Marrëveshjeje. KOSTT-i duhet të respektojë dispozitat e Paragrafit 3.2 (*Pa Diskriminim; Pa Shpronësim*), Paragrafit 3.4.2 (*Mbështetja në financim*), Paragrafit 3.4.3 (*Pëlqimi për caktimin kolateral*), si dhe Paragrafit 4.4 (*Mbështetja e QEK-së në marrje të pëlqimeve*) të Marrëveshjes së Implementimit sikur ato dispozita të ishin të vlefshme për KOSTT-in dhe të ishin pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Section 11.11. Përveç nëse parashihet ndryshe këtu, kurdo që kërkohet pëlqimi apo aprovimi nga Pala nga Pala tjetër, pëlqimi apo aprovimi i tillë nuk mund të pengohet, kushtëzohet apo vonohet pa arsye.

Section 11.12. Përveç deri në masën që përndryshe kërkohet me Kodin e Rrjetit apo këtë Marrëveshje, të gjitha njoftimet dhe komunikimet tjera të kërkuara apo lejuara për t'u dhënë nga një Palë (përfshirë faturat që kërkohen apo lejohen të dorëzohen këtu) duhet të bëhen me shkrim si dhe të dorëzohen ose personalisht ose me postë të shpejtë ose të dërgohen me faks apo email në adresën apo numrin e Palës tjetër të specifikuar si më poshtë:

(a) Nëse është për KOSTT-in:

Rr. Isa Boletini Nr. 39,
10000, Prishtinë, Kosovë
Për: Kryeshefi Ekzekutiv
Tel: +381 (0) 38 501 601 5
Fax: +381 38 500 201
E-mail: kadri.kadriu@kostt.com

Me kopje për (që nuk përbën njoftim):

Qeveria e Kosovës
Rr. Nene Tereza Nr. 36,
Prishtinë, Kosovë
Për: Ministri i Zhvillimit Ekonomik
Fax: [_____]
Email: [_____]

(b) Nëse për Gjeneratorin:

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.
35-37 Avenue de la Liberté
L-1931 Luksemburg, Dukata e Madhe e Luksemburgut
Për: Bordi i Drejtorëve
Tel: + (352) 28 86 78 00
Fax: + (352) 24 52 73 26
Email: CGK_CEO@contourglobal.com
CGK_GC@contourglobal.com

Me kusht, megjithatë, që Pala mund të ndryshojë adresën ku duhen dërguar njoftimet, duke dhënë njoftim paraprak me shkrim së paku tridhjetë (30) Ditë përpara për Palën tjetër në pajtim me këtë Section 11.12.

Asnjë njoftim e as komunikim nuk është efektiv deri sa të pranohet apo të konsiderohet i pranuar. Njoftimet apo komunikimet tjera konsiderohen të jenë pranuar nga Pala pranuese:

- (a) Kur dorëzohen, nëse dorëzohen personalisht;
- (b) Tri (3) Ditë Pune pas dërgimit, nëse dërgohen me postë të shpejtë ndërkombëtare;
- (c) Pas dërgimit, nëse dërgohen me faks, pas një konfirmimi të raportit të transmetimit të pandërprerë, si dhe me kusht që kopja në letër të dorëzohet jo më vonë se Dita vijuese e Punës tek pranuesi me postë të shpejtë ndërkombëtare ose dorëzim personal; ose
- (d) Pas dërgimit, nëse dërgohet me e-mail, me kusht që që kopja në letër të dorëzohet jo më vonë se Dita vijuese e Punës tek pranuesi me postë të shpejtë ndërkombëtare ose dorëzim personal; *me kusht, megjithatë*, që Palët munden, kohë pas kohe, të pajtohen bashkë me shkrim që nuk nevojiten kërkesat për dorëzim të kopjes në letër, duke marrë parasysh komunikimet operacionale të përditshme apo në rutinë të ngjashme.

Pala që dorëzon njoftimin apo ndonjë komunikim tjetër në pajtim me Section 11.12 duhet që të bëjë përpjekje të arsyeshme komerciale për t'i siguruar Palës pranuese përkthim arsyeshëm të saktë në gjuhën shqipe brenda pesë (5) Ditësh Pune pas dërgimit të atij njoftimi apo komunikimi tjetër në gjuhën angleze; me kusht, megjithatë, që Pala nuk do të jetë e detyruar të ofrojë përkthimin e skicave teknike apo dokumenteve inxhinierike. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet origjinalit në anglisht dhe përkthimit në shqip të njoftimit apo komunikimeve të tjera, versioni anglisht do të mbizotërojë mbi versionin shqip. Për të shmangur dyshimet, dështimi në dorëzim të përkthimit të njoftimit apo komunikimeve tjera në pajtim me këtë Section 11.12 nuk e ndikon efektshmërinë e atij njoftimi apo komunikimeve tjera sipas përcaktimit të Section 11.12.

Në rast se njoftimi i dorëzuar nga Gjeneratori tek KOSTT-i sipas kësaj Marrëveshjeje obligon KOSTT-in ose të japë përgjigje (përfshirë aprovimet apo mos-kundërshtimet) brenda një periudhe të caktuar kohore apo të konsiderohet të ketë aprovuar apo të mos ketë kundërshtuar marrjen e veprimeve nga Gjeneratori, Gjeneratori do të përfshijë në atë njoftim edhe përshkrimin e periudhës së përgjigjes si dhe pasojat e dështimit të KOSTT-it në përgjigje (përfshirë aprovimin apo mos-kundërshtimin e konsideruar si të tillë).

Section 11.13. Përveç nëse shprehimisht parashihet e kundërta me këtë Marrëveshje, asnjëra palë nuk mban përgjegjësi ndaj Palës tjetër me kontratë, detyrim, garanci, përgjegjësi strikte, apo sipas ndonjë instrumenti tjetër ligjor për asnjë lloj dëmi indirekt, pasues, incidental, ndëshkues apo ekzemplar.

Section 11.14. Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në dy (2) apo më shumë ekzemplarë origjinalë, si dhe secila kopje mund të ekzekutohet nga secila Palë në parafime të ndara, ku secila kopje kur ekzekutohet dhe dorëzohet nga Palët konsiderohet origjinale, por të gjitha këto bashkërisht përbëjnë një dhe të vetmin instrument.

PJESA 2

Section 12. Planifikimi dhe pëlqimet; Kostoja Inxhinierike.

Section 12.1. Asetet e Kycjes së re dhe Asetet e Përforcimit Infrastruktural të lidhura me këtë Marrëveshje do të renditen tek Appendix A. Ato do të paraqiten edhe në formë diagrami.

Section 12.2. Appendix A Gjithashtu posaçërisht parasheh që Gjeneratori të jetë përgjegjës për sigurimin e pëlqimeve të domosdoshme të planifikimit dhe mjedisit për Asetet e Kycjes dhe Asetet e Përforcimit Infrastruktural, si dhe i jep KOSTT-it pamjen fillestare të gjasave, si dhe kornizat kohore për marrjen e secilit pëlqim, sipas kërkesave të Kodit të Kycjeve.

Section 12.3. Merret parasysh që informatat në lidhje me pëlqimet e dhëna tek Appendix A paraqesin vlerësimet më të afërta të KOSTT-it si dhe ofrohen në mirëbesim.

Section 12.4. Brenda 90 ditësh nga kryerja e studimeve të përshkruara tek Section 13.1, Gjeneratori duhet të paguajë pjesën e parë të Kostos Inxhinierike të dhënë Appendix E (duke u pranuar që Gjeneratori do të ketë të drejtë të rimburojë pagesën e tillë në pajtim me Skemën 1 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë).

Section 12.5. Pas pagesës së pjesës së parë të Kostos Inxhinierike, Gjeneratori do të kërkojë, pa vonesë, të gjithë pëlqimet e domosdoshme të planifikimit dhe ato mjedisore për ndërtimin e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural për të cilat është përgjegjës, sipas dispozitave tek Appendix A.

Section 12.6. Pagesa e pjesës së dytë të Kostos Inxhinierike do të bëhet brenda 60 ditësh pas Datës së Fillimit të Ndërtimit (duke u pranuar që Gjeneratori ka të drejtë të rimburojë pagesën e tillë në pajtim me Skemën 1 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë). Çdo 2 muaj, secila palë do t'i dorëzojë Palës tjetër një raport progresi për përparimin e arritur deri më atë datë në avansimin e Termocentralit, Aseteve të Kyçjes si dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural. Bashkë me kopjen e raportit të progresit, KOSTT-i do të ofrojë faturën e pagesave të papaguara.

Section 12.7. Kur Gjeneratori të jetë i gatshëm të fillojë ndërtimin e Termocentralit, ai do të informojë KOSTT-in. Data kur Gjeneratori në të vërtetë fillon ndërtimin e Termocentralit përmendet si "**Data e Fillimit të Ndërtimit**".

Section 13. Asetet e Reja të Transmisionit që do ndërtohen nga Gjeneratori.

Section 13.1. Pas Datës së Ekzekutimit, Gjeneratori me shpenzimet e veta (duke pasur parasysh që Gjeneratori do të ketë të drejtë të rimburojë shpenzimet e tilla në pajtim me Skemën 1 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë) hap tenderin në pajtim me Udhërrëfyesin e Prokurimit për të angazhuar një firmë të pavarur inxhinierike arsyeshëm të pranueshme për KOSTT-in për të kryer, me shpenzimet e Gjeneratorit (duke pasur parasysh që Gjeneratori do të ketë të drejtë të rimburojë ato shpenzimet në pajtim me Skemën 1 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë), një studim të ndikimit në sistem, për të identifikuar ndikimin e Gjeneratorit tek Sistemi i Transmisionit, si dhe për të kryer studimin e fizibilitetit për të identifikuar qasjen e rekomanduar në përputhje me Praktikat e Matura të Ndërmarrjeve për kyçjen e Termocentralit me Sistemin e Transmisionit (duke përfshirë Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit dhe Asetet e Reja të Kyçjes të KOSTT-it) si dhe Asetet e nevojshme të Përforcimit të Infrastruktural që duhen ndërtuar nga Gjeneratori, si dhe për të identifikuar specifikimet e detajuara të Aseteve të Kyçjes, Aseteve Infrastruktural, si dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural që duhen ndërtuar nga Gjeneratori. Identifikimi i tillë i qasjes së rekomanduar dhe specifikimeve të detajuara duhet të marrë parasysh edhe qasjen e preferuar të Gjeneratorit dhe konsideratën teknike të KOSTT-it. Studimi i tillë do të ofrojë vlerësimet e kostos dhe afateve, si dhe duhet të ofrojë specifikimet e detajuara për të gjitha Asetet e Kyçjes dhe Asetet e Përforcimit Infrastruktural. Përgjatë përgatitjes së studimit, firma inxhinierike do të obligohet të ofrojë gjetjet e përkohshme për KOSTT-in, të konsultohet me KOSTT-in në lidhje me kyçjen dhe gjetjet e propozuara, si dhe të marrë parasysh rekomandimet dhe kërkesat e KOSTT-it. Pas përfundimit të studimeve, si dhe aprovimin e arsyeshëm të KOSTT-it për to, palët do të ndryshojnë këtë Marrëveshje për të përfshirë tek Appendix A dhe Appendix B specifikimet e detajuara të Aseteve të Kyçjes, Aseteve Infrastruktural, si dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural që duhen ndërtuar nga Gjeneratori. KOSTT nuk merr përsipër asnjë lloj obligimi në këtë marrëveshje që të ofrojë shërbimet e interkoneksionit deri në atë ndryshim. Palët duhet të bëjnë përpjekje komercialisht të arsyeshme për të përfunduar këtë proces brenda dymbëdhjetë (12) muajsh pas Datës Efektive.

Section 13.2. Përgjegjësia për marrjen e tenderëve për Asetet e Kyçjes dhe Asetet e Përforcimit Infrastruktural që duhen ndërtuar nga Gjeneratori bie mbi Gjeneratorin, si dhe Gjeneratori do të jetë

përgjegjës për ndërtimin e Aseteve të Kyçjes si dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural të parapara këtu.

Section 13.3. Me pranimin e tenderëve për ndërtimin e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural, pjesët e tenderëve të lidhura me Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Asetet e Përforcimit Infrastruktural do të dërgohen nga Gjeneratori tek KOSTT-i për vlerësim. Këto informata do të përfshijnë Vlerën Moderne Ekuivalente të Aseteve (MEAV) për secilin artikull të pajisjeve. Për secilin tender, KOSTT-i do të deklarojë nëse është i pranueshëm, duke dhënë edhe arsyet për refuzim, brenda 30 ditësh. Nëse Gjeneratori dëshiron të shfrytëzojë tenderin e konsideruar të papranueshëm nga KOSTT-i, çështja do të zgjidhet në pajtim me dispozitat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tek Section 8. Kjo mund të përfshijë edhe rastin kur MEAV konsiderohet e papranueshme për KOSTT-in.

Section 13.4. Kontrata të cilën Gjeneratori lidh për Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Asetet e Përforcimit Infrastruktural duhet të sigurojë që garancitë mbijetuese të mbeten të vlefshme edhe pas bartjes së pronësisë të përmendura tek Section 13.11. Kontrata duhet gjithashtu të specifikojë standardet minimale për kryerjen dhe komisionimin e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural, të cilat duhet të jenë në përputhje me Kodin e Rrjetit, si dhe Kodin e Pajisjeve Elektrike.

Section 13.5. Pasi tenderët të jenë dorëzuar, Gjeneratori duhet të krijojë një “**Panel Ndërtimi**”, të përbërë nga përfaqësuesit e Gjeneratorit, që do të menaxhojë dhe mbikëqyrë ndërtimin e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural. KOSTT-i duhet të ftohet të marrë pjesë në mbledhjet periodike të këtij Paneli të Ndërtimit në lidhje me ndërtimin e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural; *me kusht, megjithatë*, që pjesëmarrja e KOSTT-it në mbledhjet e Panelit të Ndërtimit të mos e lirojë Gjeneratorin nga asnjë lloj përgjegjësie që përndryshe do të kishte sipas kësaj Marrëveshjeje, apo ndonjë marrëveshjeje tjetër të ndërlidhur me Projektin Kosova e Re, si dhe që KOSTT-i të mos marrë asnjë lloj përgjegjësie që rrjedh vetëm nga pjesëmarrja e tij në atë mbledhje.

Section 13.6. Gjeneratori duhet të projektojë, të prokurtojë pajisjet, si dhe të ndërtojë Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Asetet e Përforcimit Infrastruktural në pajtim me specifikimet e dhëna nga KOSTT-i, Kodin e Rrjetit, Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes, si dhe Metodologjinë e Tarifave të Kyçjes në Transmission.

Section 13.7. Në çdo kohë gjatë ndërtimit, pas ofrimit për Gjeneratorin të njoftimit paraprak me shkrim prej së paku dy (2) Ditësh Pune, KOSTT-i ka të drejtë që gjatë orarit normal të punës të ketë qasje në vendpunishte ndërtimi të Aseteve të Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural, si dhe të bëjë inspektimin e saj. Të gjithë personat që vizitojnë Termocentralin apo lokacionin e Termocentralit në emër të KOSTT-it do të respektojnë rregulloret dhe procedurat përgjithësisht në zbatim për sigurinë të Gjeneratorit dhe Kontraktorëve të Gjeneratorit në pajtim me Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes, Ligjet e Kosovës, si dhe Standardet e zbatueshme që i janë vënë në dispozicion atyre personave, si dhe duhet të respektojnë udhëzimet dhe urdhëresat e Gjeneratorit dhe Kontraktorëve të Gjeneratorit, si dhe të mos shkaktojnë ndonjë ndërhyrje të panevojshme apo edhe pengim të aktiviteteve të Gjeneratorit apo Kontraktorëve në lokacion. Rregulloret dhe procedurat e tilla të sigurisë mund të ndryshojnë kohë pas kohe. Gjeneratori duhet t'i raportojë periodikisht KOSTT-it mbi progresin e arritur në projektim, prokurim si dhe ndërtim, ndërsa KOSTT-i mundet, në çdo kohë, të kërkojë raport progresi nga Gjeneratori. Duke mos anashkaluar pikat paraprake, KOSTT-i do të ketë të drejtë të propozojë korrigjime të arsyeshme në rregulloret dhe procedurat e sigurisë si më lart, ndërsa Gjeneratori në masë të arsyeshme duhet të trajtojë ato korrigjime të propozuara.

Section 13.8. Jo më pak se katër muaj para fillimit të propozuar të komisionimit të Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural, Gjeneratori duhet t'i dorëzojë KOSTT-it të gjitha informatat e dizajnit të kërkuara sipas Paragrafit 11.2.1.2 të Kodit të Kyçjeve.

Section 13.9. Nëse në cilindo moment gjatë ndërtimit të Aseteve të Kyçjes së Re të KOSTT-it apo Aseteve të Përforcimit Infrastruktural, KOSTT-i me arsye vlerëson që asetet e tilla nuk përputhen me

Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes, kriteret e Kodit të Rrjetit, apo specifikimet e dhëna nga KOSTT-i, Gjeneratori do të obligohet të korrigojë mangësitë në ato stabilimente.

Section 13.10. Kur Asetet e Kyçjes dhe Asetet e Përforcimit Infrastrukturor të jenë kryer dhe janë gati të testohen e të komisionohen, Gjeneratori duhet të informojë KOSTT-in dhe t'i dorëzojë KOSTT-it me shkrim programin përfundimtar të testimit, duke përfshirë kohëzgjatjen e pritur të programit të testimit nga Gjeneratori, si dhe një kornizë kohore tentative për kryerjen e të gjitha testeve të nevojshme. Në përputhje me atë kornizë kohore (që mund të rishikohet kohë pas kohe), Gjeneratori teston dhe komisionon Asetet e Kyçjes dhe Asetet e Përforcimit Infrastrukturor. KOSTT-i ka të drejtë të jetë i pranishëm si dëshmitar në testet e komisionimit. Të gjitha kontestet në lidhje me testimin dhe komisionimin duhet të zgjidhen në pajtim me dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tek Section 8.

Section 13.11. Pas komisionimit të Aseteve të Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Aseteve të Përforcimit Infrastrukturor, në Datën e Kyçjes, Gjeneratori i bart pronësinë e Aseteve të Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Aseteve të Përforcimit Infrastrukturor tek KOSTT-i, pa kurrfarë pagese dhe pa asnjë barrë (duke përfshirë ato në dobi të Huadhënësit (siç definohen në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë)) përveç Barrëve të Lejuara, si dhe pas bartjes, të paguajë tarifën e mirëmbajtjes për atë asete, në pajtim me Metodologjinë e Tarifave të Kyçjes në Transmision. Pas bartjes, Gjeneratori i dorëzon KOSTT-it të gjitha skicat e ndërtimit, informatat si dhe dokumentet tjera që me arsye kërkohen nga KOSTT-i për operimin dhe mirëmbajtjen e Aseteve të Kyçjes së Re të KOSTT-it si dhe Aseteve të Përforcimit Infrastrukturor. Toka dhe të gjitha të drejtat mbi tokën që lidhet me Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Asetet e Përforcimit Infrastrukturor gjithashtu, në Datën e Kyçjes, i barten KOSTT-it pa kurrfarë pagese.

Section 13.12. Gjeneratori mban pronësinë e Aseteve të Kyçjes së Gjeneratorit.

Section 13.13. Përgjatë gjithë periudhës në të cilën mban pronësinë e Aseteve të Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Aseteve të Përforcimit Infrastrukturor, Gjeneratori i mban ato Asete të Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Asete të Përforcimit Infrastrukturor të lira dhe pa kurrfarë barre, përveç Barrëve të Lejuara, si dhe atyre në dobi të huadhënësve, në pajtim me Section 11.9.

Section 13.14. Përveç dispozitës specifike si më poshtë apo tjetërkund në këtë Marrëveshje apo në Marrëveshjet e Projektit, Gjeneratori liron nga përgjegjësia dhe mbron KOSTT-in dhe çdo Palë të KOSTT-it nga të gjitha Humbjet e pësuar apo që duhen paguar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga apo që vendosen mbi KOSTT-in apo ndonjë Palë të KOSTT-it në të gjitha rastet pas Datës Efektive: (a) për lëndime personale apo vdekje të personave apo dëme ndaj pronës të cilat rrjedhin nga neglizhenca apo veprimi i qëllimshëm nga Gjeneratori apo ndonjë Palë e Gjeneratorit në lidhje me këtë Marrëveshje; (b) në lidhje me ndonjë pretendim apo mocion nga ndonjë palë e tretë, i cili lind nga, apo lidhet me shkeljen nga Gjeneratori të Ligji të Kosovës; (c) në lidhje me ndonjë pretendim apo mocion nga ndonjë palë e tretë, i cili lind nga, apo lidhet me shkeljen apo mospërmbushjes nga Gjeneratori të zotimeve apo garancive të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje, ose (d) që del nga, lidhet me, apo lind prej ndonjë Gjendjeje Mjedisore/Arkeologjike në lidhje me të drejtën e kalimit për avancimin e Kyçjeve që hyn në fuqi pas Datës së Bartjes deri në masën që ajo Gjendje Mjedisore/Arkeologjike shkaktohet nga Gjeneratori apo ndonjë Person nën kontrollin e Gjeneratorit apo ndonjë palë e tretë, deri në masën që Gjeneratori, duke vepruar në pajtim me Praktikat e Matura të Ndërmarrjeve, do të mund të parandalonte Gjendjen Mjedisore/Arkeologjike që është shkakuar nga ajo palë e tretë, si dhe përveç deri në masën që ajo përgjegjësi lind nga ndonjë Gjendje Mjedisore/Arkeologjike që ka ekzistuar në apo para Datës së Bartjes ose rezulton nga apo lidhet me ndonjë veprim apo mosveprim të KOSTT-it apo ndonjë Palë të KOSTT-it. Kjo dispozitë shprehimisht mbijeton përtej çdo shkëputjeje apo ndërprerjeje të kësaj Marrëveshjeje.

Section 13.15. Pas bartjes së Aseteve të Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Aseteve të Përforcimit Infrastrukturor, Gjeneratori nuk do të ketë obligime apo detyrime të tjera në lidhje me ato stabilimente.

Përveç dispozitës specifike si më poshtë apo tjetërkund në këtë Marrëveshje apo në Marrëveshjet e Projektit, KOSTT liron nga përgjegjësia dhe mbron Gjeneratorin dhe çdo Palë të Gjeneratorit, në të gjitha kohët pas Datës Efektive, nga të gjitha Humbjet e pësuar apo që duhen paguar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga apo që vendosen mbi Gjeneratorit apo ndonjë Palë të Gjeneratorit: (a) për lëndime personale apo vdekje të personave apo dëme ndaj pronës të cilat rrjedhin nga neglizhenca apo veprimi i qëllimshëm nga KOSTT-i apo ndonjë Palë e KOSTT-it në lidhje me këtë Marrëveshje; (b) në lidhje me ndonjë pretendim apo mocion nga ndonjë palë e tretë, i cili lind nga, apo lidhet me shkeljen nga KOSTT-i të Ligjit të Kosovës; (c) në lidhje me ndonjë pretendim apo mocion nga ndonjë palë e tretë, i cili lind nga, apo lidhet me shkeljen apo mospërmbushjes nga KOSTT-i të zotimeve apo garancive të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje; (d) të gjitha Humbjet e pësuar apo të kërkuara që të paguhen, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga apo që kërkohen të vendosen ndaj, gjeneratorit apo ndonjë Palë të Gjeneratorit, që rezulton nga, lidhet me, apo lindin prej ndonjë Gjendjeje Mjedisore/Arkeologjike në lidhje me të Drejtën e Kalimit për Avancimin e Kycjes që ka ekzistuar në apo para Datës së Bartjes, përveç deri në masën që detyrimet e tilla (i) rezultojnë nga, lidhen me, ose lindin nga ndonjë veprim i Gjeneratorit apo ndonjë Dege Vartëse apo Personi nën kontrollin e Gjeneratorit, duke përfshirë në lidhje me fillimin (duke përfshirë edhe para Datës së Bartjes, nëse ka) e aktiviteteve të Gjeneratorit në të Drejtën e Kalimit për Avancim të Kycjes, ose (ii) zhduken nga QEK-ja në pajtim me Paragrafin 8.2 (*Zhdëmtimi për Standarde Mjedisore*) të Marrëveshjes së Implementimit apo lidhen me shpenzimet apo Humbjet që janë të pagueshme apo janë paguar për Gjeneratorin në pajtim me Nenin 15 (*Rehabilitimi Mjedisor*) të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë; si dhe (e) rezultojnë nga, lidhen me, apo rrjedhin nga ndonjë Gjendje Mjedisore/Arkeologjike në lidhje me të Drejtën e Kalimit të Marrëveshjes së Kycjes së KOSTT-it që hyn në fuqi pas Datës së Bartjes, duke përfshirë edhe gjendjet që rezultojnë nga veprimi apo mosveprimi i KOSTT-it apo ndonjë palë të KOSTT-it, përveç deri në masën që ato detyrime rezultojnë nga apo lidhen me ndonjë veprim të Gjeneratorit apo ndonjë Personi nën kontrollin e Gjeneratorit apo të një palë të tretë deri në masën që Gjeneratori, duke vepruar në pajtim me Praktikën e Matura të Ndërmarrjes, do të mund të parandalonte Gjendjen Mjedisore/Arkeologjike të shkaktuar nga ajo palë e tretë. Kjo dispozitë shprehimisht mbijeton përtej çdo shkëputjeje apo ndërprerjeje të kësaj Marrëveshjeje.

Section 13.16. Në rast se lëndimi apo dëmtimi rezulton nga neglizhenca apo edhe kundërvajtja e qëllimshme e Palëve, secila Palë mban përgjegjësi sipas kësaj Marrëveshjeje në proporcion me pjesën relative të fajit të vet.

Section 13.17. Duke mos anashkaluar asnjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshjeje, në asnjë rast, KOSTT-i apo Gjeneratorit apo apo ndonjë Palë e KOSTT-it apo Gjeneratorit nuk mund të zhduket deri në masën që Humbjet e mundshme janë shkaktuar nga neglizhenca apo kundërvajtja e qëllimshme e tyre, apo shkelja nga ana e tyre e kushteve të kësaj Marrëveshjeje apo Marrëveshjeve të Projektit, si dhe në asnjë rast, KOSTT-i apo Gjeneratori apo ndonjë Palë e KOSTT-it apo Gjeneratorit nuk mund të zhduket për ndonjë humbje deri në masën që ajo Palë tashmë ka pranuar të ardhurat nga sigurimi apo të ardhurat nga një palë e tretë për këtë, apo ka pranuar apo ka fituar të drejtën e pagesës nga QEK apo ndonjë NP e Specifikuar sipas ndonjë Marrëveshjeje tjetër të Projektit.

Obligimet e zhdëmtimit të Palëve të kësaj Marrëveshjeje zbriten për shumën, si dhe në lidhje me, rimbursimet nga sigurimet apo rimbursimet nga palët e treta nga një Palë e zhdëmtuar për Humbjet e zhdëmtuara me këtë marrëveshje. Nëse Pala bën pagesa në pajtim me detyrimet e saj të zhdëmtimit sipas kësaj marrëveshjeje sa i përket shumave për të cilat siguresi apo ndonjë palë tjetër e tretë mund të ketë përgjegjësi ligjore, ajo Palë konsiderohet, deri në masën e nevojshme, e nën-siguruara e barazueshme në lidhje me, si dhe bartësja kontraktuale apo juridike, e të drejtës për kërkimin e rimbursimit të atyre shumave nga siguresi apo pala e tretë, deri në lartësinë e të drejtave të tilla.

Për të shmangur dyshimet, kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohen të kenë tkurrur, penguar, privuar, modifikuar apo zëvendësuar kushtet e ndonjë polise të aplikueshme të sigurimit, që gjithashtu ofron mbulesë për Humbjet e zhdëmtuara. Duke mos anashkaluar pikat paraprake,

zbatueshmëria e polisës së mundshme të sigurimit apo dështimi i siguresit për të përmbushur obligimet e veta për zhdëmtimin e Humbjeve nuk fal, nuk vonon e as nuk zvogëlon obligimet e zhdëmtimit të Palës zhdëmtuese në asnjë kuptim, e as nuk arsyeton mospërmbushjen e obligimeve të tilla të asaj Pale për zhdëmtim; megjithatë, në përcaktimin e obligimeve respektive ndërmjet Palës zhdëmtuese dhe ndonjë siguresi, duke pasuar pagesat e Palës në pajtim me obligimin e saj për zhdëmtim sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe në lidhje me ndonjë kontest ndërmjet asaj Pale zhdëmtuese si dhe atij siguresi në lidhje me obligimin e siguresit për të rimbursuar Palën zhdëmtuese apo për të ofruar mbulesë tjetër për humbjen e zhdëmtuar, çdo sigurim i zbatueshëm (me përjashtim të minuseve apo mbajtjeve të zbatueshme) do të konsiderohet primare si obligim i zhdëmtimit të përcaktuar me këtë marrëveshje, si dhe obligimet e zhdëmtimit të përcaktuara me këtë marrëveshje do të konsiderohen si posaçëm të jenë ertej sigurimeve të tilla të vlefshme, por vetëm deri në masën e shumave që janë paguar tashmë për të siguruarin në atë kontratë sigurimi, si dhe me mirëkuptim e mëtutjeshëm që Pala zhdëmtuese në të gjitha rastet do të jetë përgjegjëse për Humbjen e zhdëmtuar, deri në masën e obligimeve të veta të zhdëmtimit të përcaktuara këtu, brenda minuseve apo mbajtjeve të përcaktuara me atë sigurim të vlefshëm.

Section 13.18. Mbrojtja e Kërkesave

(a) Njoftimi për Kërkesat.

- (i) Pala duhet që të njoftojë menjëherë Palën tjetër, me shkrim, për humbjet e mundshme apo procedurat në lidhje me të cilat Pala njoftuese është apo mund të fitojë të drejtën e zhdëmtimit në pajtim me këtë Marrëveshje (“**Njoftimi për Zhdëmtimin**”).
- (ii) Vonesa apo dështimi i Palës së tillë të zhdëmtuar për të bërë Njoftimin e Zhdëmtimit që kërkohet në pajtim me këtë Section 13.18 për Palën tjetër nuk e liron Palën Zhdëmtuese nga obligimi i zhdëmtimit që mund të ketë ndaj asaj Pale të zhdëmtuar, përveç deri në masën që ai dështim apo vonesë ka ndikuar materialisht dhe negativisht mundësinë e Palës zhdëmtuese për të mbrojtur veprimin e tillë apo ka rritur shumën e Humbjeve.
- (iii) Pala të cilës i dërgohet Njoftimi për Zhdëmtim duhet të konfirmojë pranimin e atij Njoftimi, me shkrim, brenda shtatë (7) Ditësh Pune pas pranimit të Njoftimit për Zhdëmtim (“**Konfirmimi i Zhdëmtimit**”).

(b) Mbrojtja e Kërkesave.

- (i) Pas pranimit të Njoftimit për Zhdëmtim, si dhe me kusht që Konfirmimi i Zhdëmtimit të konfirmojë obligimin për të zhdëmtuar Palën e zhdëmtuar deri në masën e nevojshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala zhdëmtuese ka të drejtë, me zgjedhjen e vet, të marrë përsipër dhe të kontrollojë mbrojtjen e kërkesës, veprimin, padisë apo procedurës së tillë me shpenzimet e veta dhe me përfaqësues të zgjedhur nga ajo vetë, duke iu nënshtruar aprovimit paraprak të Palës së zhdëmtuar, ndërsa aprovimi i tillë nuk mund të pengohet, kushtëzohet, vonohet apo mohohet pa arsye. Nëse ajo Palë zhdëmtuese zgjedh të marrë përsipër dhe të kontrollojë mbrojtjen e kërkesës, veprimin, padisë apo procedurës së tillë, ajo duhet ta njoftojë Palën e zhdëmtuar për atë zgjedhje në Konfirmimin e Zhdëmtimit.
- (ii) Përveç dhe derisa Pala zhdëmtuese konfirmon obligimin e saj për të zhdëmtuar Palën e zhdëmtuar deri në masën e kërkuar sipas këtij në Konfirmimin e Zhdëmtimit, si dhe merr përsipër kontrollin e mbrojtjes së kërkesës, padisë, veprimin apo procedurës, Pala e zhdëmtuar do të ketë të drejtë, por jo obligim, që të kontestojë, mbrojtjen, si dhe mbrojtjen në gjyq, me përfaqësues juridik të zgjedhur nga ajo vetë, çdo kërkesë, veprim, padi apo procedurë të cilësdo palë të tretë të ngritur apo pretenduar ndaj asaj Pale në lidhje me, atë që rezulton, lidhet me apo lind nga cilado çështje për të cilën ka të drejtë të zhdëmtohet sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe kostot dhe shpenzimet e

dokumentuara, të arsyeshme, si dhe të matura të këtyre veprimeve do t'i nënshtrohen obligimeve të zhdëmtimit, si dhe të rimbursohen menjëherë, nga pala zhdëmtuese sipas kësaj marrëveshjeje.

- (iii) As Pala zhdëmtuese e as Pala e zhdëmtuar nuk kanë të drejtë të negociojnë asnjë kërkesë, veprim, padi apo procedurë pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër (ku pëlqimi i tillë nuk mund të pengohet, kushtëzohet, vonohet apo mohohet pa arsye); *me kusht, megjithatë*, që pas pajtimit me shkrim për të zhdëmtuar Palën e zhdëmtuar, nëse Pala zhdëmtuese fiton zgjidhjen e plotë të çështjeve që kanë të bëjnë me Palën e zhdëmtuar (duke përfshirë, pa u kufizuar në të, lirimin e plotë të Palës së zhdëmtuar nga e gjithë përgjegjësia e mëtutjeshme në lidhje me kërkesat e parashtruara) si dhe vendimet e nevojshme të gjykatës që aprovojnë atë marrëveshje, Pala zhdëmtuese mund të zgjidhë kërkesat e tilla edhe pa pëlqimin e Palës së zhdëmtuar.
- (iv) Nëse Pala zhdëmtuese zgjedh të marrë përsipër dhe të kontrollojë mbrojtjen e kërkesës, veprimit, padisë apo procedurës, Pala e zhdëmtuar duhet t'i ofrojë Palës zhdëmtuese informatat që Pala zhdëmtuese mund të kërkojë me arsye, në lidhje me kërkesën, veprimin, padinë apo procedurën, si dhe duhet që (deri në masën përkatëse) të informojë Palën zhdëmtuese plotësisht për zhvillimet materiale në procedimin e kërkesës, veprimit, padisë apo procedurës së tillë.

(c) Shpenzimet e përfaqësimit ligjor.

- (i) Pas pranimit të Konfirmimit të Zhdëmtimit dhe marrjes përsipër të mbrojtjes nga Pala zhdëmtuese, Pala e zhdëmtuar do të ketë të drejtë të angazhojë përfaqësuesin e vet ligjor, si dhe përfaqësuesi i tillë mund të marrë pjesë në atë veprim, por tarifat dhe shpenzimet e përfaqësuesit të tillë do të barten ekskluzivisht nga ajo Palë e zhdëmtuar, kurdo dhe sido të shkaktohen, përveç nëse:
 - (A) Angazhimi i përfaqësuesit nga Pala e zhdëmtuar është autorizuar me shkrim nga Pala zhdëmtuese dhe Pala zhdëmtuese është pajtuar të paguajë tarifat dhe shpenzimet e atij përfaqësuesi;
 - (B) Pala e zhdëmtuar duhet të ketë konstatuar me arsye dhe posaçërisht duhet të ketë njoftuar Palën zhdëmtuese që mund të ketë konflikt interesash mes Palës zhdëmtuese dhe Palës së zhdëmtuar në mbrojtjen e atij veprimi;
 - (C) Pala zhdëmtuese nuk duhet të ketë angazhuar në fakt përfaqësues të pavarur juridik të kënaqshëm për Palën e zhdëmtuar për të marrë përsipër mbrojtjen e atij veprimi, si dhe duhet të ketë njoftuar për këtë Palën e zhdëmtuar; ose
 - (D) Pala e zhdëmtuar duhet të ketë konstatuar me arsye dhe posaçërisht duhet të ketë njoftuar Palën zhdëmtuese që mund të ketë mbrojtje specifike në dispozicion të saj që është ndryshe apo plotësuese ndaj asaj që është në dispozicion të Palës zhdëmtuese apo që ajo kërkesë, veprim, padi apo procedurë përmban apo mund të ketë efekt negativ material mbi Palën e zhdëmtuar përtej fushëveprimit të kësaj Marrëveshjeje.
- (ii) Nëse Section 13.18(c), (i)(A)(C), Section 13.18(c)(i), ose Section 13.18(c) zbatohen, atëherë Pala e zhdëmtuar do të ketë të drejtë të drejtojë mbrojtjen e asaj kërkesë, veprimi, padie apo procedure si e vetme, si dhe tarifat dhe disbursimet, e dokumentuara të përfaqësuesit të pavarur të angazhuar nga Pala e zhdëmtuar përbëjnë shpenzime të zhdëmtuara dhe të rimbursueshme ligjore apo të tjera, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Section 14. Rimbursimi për disa Kosto të Aseteve të Përforcimit Infrastrukturor.

Section 14.1. Duke mos anashkaluar dispozitat e Section 13.11, KOSTT-i duhet të rimbursojë Gjeneratorin për kostot e Aseteve të Përforcimit Infrastrukturor deri në masën që ato kosto tejkalojnë shumën prej dy milionë Euro (€2,000,000).

Section 14.2. Në rast se kostot e Aseteve të Përforcimit Infrastrukturor tejkalojnë dy milionë euro (€2,000,000), Gjeneratori duhet t'i dorëzojë KOSTT-it një faturë në Euro për të gjitha shumat borxh, në baza mujore në detyrime pagese nga KOSTT-i në pajtim me Section 14.3, bashkë me informatat mbështetëse që mund të jenë me arsye të domosdoshme për të dëshmuar shumat e paraqitura në faturë.

Section 14.3. KOSTT-i duhet t'i paguajë Gjeneratorit shumën e paraqitur në faturën e dorëzuar në pajtim me Section 14.2, minus zbritjet për shumat apo pjesët e shumave të kontestuara të paraqitura në faturën e dorëzuar, në datën apo para Ditës së tridhjetë (30) pas Ditës kur fatura është pranuar nga KOSTT-i (ose në rast se ajo Ditë nuk është Ditë Pune, Ditën vijuese të Punës pas saj). Të gjitha kontestet në lidhje me faturat e tilla duhet të zgjidhen në pajtim me dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tek Section 8. Pagesat e vonuara për Gjeneratorin i nënshtrohen kamatave plotësuese me Normën e Pagesës së vonuar.

Section 15. Termocentrali Hyn në Funkcion.

Section 15.1. Gjeneratori dhe KOSTT-i janë pajtuar mbi ndarjen e përgjegjësive për lokacionin e kyçjes siç parashihet tek Appendix F. Para komisionimit të Termocentralit, Gjeneratori duhet t'i ofrojë KOSTT-it të dhënat e kërkuara sipas Section 5.5 si dhe një Deklaratë që Termocentrali plotëson kërkesat e Kodit të Kyçjeve, bashkë me të gjitha kriteret teknike të Appendix C.

Section 15.2. KOSTT- ka të drejtë, pas një njoftimi paraprak me shkrim prej dy (2) Ditësh Pune, të testojë pajisjet dhe Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit për të siguruar përputhshmërinë e tyre me Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes, kushtet e kësaj Marrëveshjeje, si dhe Kodin e Rrjetit. Gjeneratori mund të marrë pjesë në testimin e Aseteve të Kyçjes së Gjeneratorit, në pajtim me Kodin e Rrjetit (Kodi Operacional).

PJESA 3

Section 16. Pika e Kyçjes dhe Asetet e Transmisionit.

Section 16.1. Detajet e Pikës së Kyçjes dhe asetet përkatëse për të cilat vlen kjo Marrëveshje janë ashtu siç specifikohen me Shtojcat Appendix A dhe Appendix B.

Section 16.2. Gjeneratori mirëmban dhe operon me Termocentralin e tij dhe Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit në mënyrë të sigurt dhe të besueshme në pajtim me Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes, Kodin e Rrjetit, si dhe kushtet specifike teknike të Pikës së Kyçjes të paraqitura tek Appendix C. KOSTT mirëmban dhe operon me Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it dhe Asetet Infrastrukturore në mënyrë të sigurt dhe të besueshme në pajtim me Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes, Kodin e Rrjetit, si dhe kushtet specifike teknike të Pikës së Kyçjes të paraqitura tek Appendix C.

Section 16.3. Edhe KOSTT-i edhe Gjeneratori duhet të sigurojnë që stabilimentet mbrojtëse të instaluar në Qarqet e Interkoneksionit të mbeten në funksion, si dhe që stabilimentet e tilla të mos ndryshohen, ndërrohen apo mirëmbahen pa pajtimin e Palës tjetër.

Section 17. Zhvillimi i Ardhshëm i Sistemit.

Section 17.1. Gjeneratori pranon që KOSTT-i është i obliguar të sigurojë stabilitetin e Sistemit të Transmisionit, të shmangë ndonjë pasojë dëmtuese tek Përdoruesit e tjerë të Sistemit të Transmisionit, si dhe të mirëmbajë, avancojë e zgjerojë Sistemin e Transmisionit në pajtim me Kodin e Rrjetit, pa paragjykuar të drejtat e Gjeneratorit sipas Kodit të Rrjetit dhe kësaj Marrëveshjeje.

Section 17.2. Në rast së KOSTT-i konsideron që kërkohet ndonjë ndryshim në Pikën e Kyçjes sipas Section 17.1, atëherë KOSTT-i do të ketë të drejtë të kërkojë ndryshime të arsyeshme në Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit dhe Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it si dhe Asetet Infrastrukturore.

Section 17.3. Gjeneratori obligohet të informojë KOSTT-in për ndryshimet substanciale në Pikën e Kyçjes, të cilat mund të ndikojnë në përputhshmërinë e tij me Kodin e Rrjetit dhe këtë Marrëveshje.

Section 17.4. Ose Gjeneratori ose KOSTT-i mund të bëjnë modifikime të tjera në stabilimentet e veta që adresohen me këtë Marrëveshje. Nëse ose Gjeneratori ose KOSTT-i planifikojnë të bëjnë modifikime që me arsye mund të priten të ndikojnë tek stabilimentet e palës tjetër, ajo Palë që bën atë modifikim duhet t'i ofrojë Palës tjetër informata të mjaftueshme në lidhje me ato modifikime, ashtu që Pala tjetër të mund të vlerësojë ndikimin potencial të modifikimeve të tilla para fillimit të punës. Informatat e tilla duhet të përfshijnë informatat në lidhje me oraret e modifikimeve të tilla si dhe nëse ato modifikime priten të ndërpresin rrjedhën e energjisë elektrike nga Termocentrali. Pala që dëshiron të kryejë punë të tilla duhet të ofrojë skicat, planet dhe specifikimet relevante për Palën tjetër së paku 90 ditë para fillimit të punëve. Të gjitha punët e tilla duhen kryer ashtu që të minimizohet deri në masën arsyeshëm të mundshme ndikimi mbi Palën tjetër si dhe mbi Sistemin e Transmisionit.

Section 18. Kapaciteti i Kyçjes.

Section 18.1. Gjeneratori nuk mund të eksportojë energji elektrike drejt Sistemit të Transmisionit duke tejkalar Kapacitetin e Kyçjes të specifikuar tek Appendix D. Në rastin kur Gjeneratori shkel këtë dispozitë, KOSTT-i ruan të drejtën për të de-energizuar dhe/ose shkyçur Termocentralin në pajtim me Section 19.

Section 18.2. Gjeneratori nuk mund të importojë energji elektrike nga Sistemi i Transmisionit duke tejkalar Kapacitetin e Importimit të Gjeneratorit, të specifikuar tek Appendix D. Në rastin kur Gjeneratori shkel këtë dispozitë, KOSTT-i ruan të drejtën për të de-energizuar dhe/ose shkyçur Termocentralin në pajtim me Section 19. Gjeneratori zhdëmtton KOSTT-in për të gjitha humbjet që KOSTT-i mund të pësojë (duke përfshirë ndëshkimet financiare që mund të vendosen ndaj KOSTT-it nga ndonjë organizim rajonal energjetik i autorizuar) si pasojë e shkeljes nga Gjeneratori të këtij Section 18.2.

Section 19. Të Drejtat e Kyçjes.

Section 19.1. Gjeneratori duhet të ketë qasje në Sistemin e Transmisionit në pajtim me Kodin e Rrjetit. KOSTT-i është përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Transmisionit sipas nevojës për t'i mundësuar Gjeneratorit të dorëzojë Kapacitetin e Kyçjes tek Pika e Kyçjes, si dhe të pranojë energji elektrike, sipas kërkesës, në pajtim me këtë Marrëveshje.

Section 19.2. Pa anashkalar pikat e sipërme, KOSTT-i ruan të drejtën të de-energizojë dhe/ose të shkyçë Termocentralin nëse:

- (a) Merr udhëzim që të de-energizojë nga Operatori i Tregut sipas Nenit 16 të Rregullave të Tregut (deri në masën që Gjeneratori merr pjesë në treg);
- (b) Gjeneratori shkel ndonjë prej obligimeve substanciale sipas Kodit të Rrjetit apo kësaj Marrëveshjeje;
- (c) mbajtja e kyçjes në operim do të ndikonte negativisht në masë substanciale Sistemin e Transmisionit si dhe/ose furnizimin e energjisë elektrike ndaj Përdoruesve të tjerë në pajtim me standardet teknike të zbatueshme, ashtu që një operator i matur i Sistemit të Transmisionit që vepron në pajtim me standardet përgjithësisht të pranuar do të de-energizonte dhe/ose të shkyçte Termocentralin;
- (d) Ka bazë të arsyeshme për të konstatuar që mbajtja e kyçjes në shërbim do të rrezikonte substancialisht sigurinë e personave apo pronës;

- (e) KOSTT-i duhet të kryejë punë arsyeshëm të domosdoshme në Sistemin e Transmisionit, duke përfshirë Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it, për kohëzgjatjen e atyre punimeve. Në lidhje me këto: Për punimet e tilla, duhet të ofrohet njoftim i shkruar me kohë për Gjeneratorin sipas Kodit të Planifikimit Operativ të Kodit të Rrjetit, KOSTT-i merr përsipër të bëjë përpjekje komercialisht të arsyeshme për të konsultuar Gjeneratorin paraprakisht (përveç në raste emergjence) për ato raste dhe të marrë parasysh kërkesat e GenCo-s në lidhje me to (pa kufizuar të drejtat e KOSTT-it), ndërsa KOSTT-i merr përsipër të ofrojë informata të vazhdueshme mbi përfundimin e pritur të atyre rasteve kohë pas kohe;
- (f) Në rrethanat e përshkruara tek Paragrafët Section 18.1 ose Section 18.2; ose
- (g) Gjeneratori kërkon që KOSTT-i të de-energizojë dhe/ose shkyçë Termocentralin.

Shpejt pas zgjidhjes së ngjarjeve që kanë rezultuar me de-energizimin apo shkyçjen e Termocentralit, KOSTT-i duhet të ndërmarrë veprimet e tilla që janë të domosdoshme për të ri-energizuar apo rikyçur Termocentralin në pajtim me Kodin e Rrjetit.

Section 19.3. KOSTT-i nuk do të mbajë përgjegjësi për asnjë aksident apo dëmtim të pajisjeve të Gjeneratorit apo humbje të tjera për operacionet e kryera në pajtim me Section 19.2, për aq sa vepron në përputhje me standardet e operatorit të sistemit të Transmisionit kur vepron në pajtim me standardet përgjithësisht të pranuar.

Section 19.4. Gjeneratori nuk do të mbajë përgjegjësi për asnjë humbje të ardhurash apo Humbje të tjera të KOSTT-it derisa furnizimi është i shkyçur apo de-energizuar, përveç atyre në lidhje me obligimin e zhdëmtimit të Gjeneratorit të paraparë këtu, për aq sa vepron në përputhje me Praktikën e Kujdesshme të Ndërmarrjes.

Section 20. Kalkulimi dhe pagesa e Ngarkesës për Përdorimin e Sistemit të Transmisionit, Ngarkesës për Operim të Sistemit, si dhe Ngarkesës për Operim të Tregut.

Section 20.1. Ngarkesa për Operimin e Sistemit dhe Ngarkesa për Operimin e Tregut për Pikën e Kyçjes sipas kësaj Marrëveshjeje janë të pagueshme që nga Data e Kyçjes.

Section 20.2. Ngarkesa për Operim të Sistemit dhe Ngarkesa për Operim të Tregut për Pikën e Kyçjes sipas kësaj Marrëveshjeje duhen paguar në pajtim me Metodologjinë e Pagesave të OS-së dhe Metodologjinë e Pagesave për OT, miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). Ngarkesa për Operimin e Sistemit dhe Ngarkesa për Operim të Tregut që janë të vlefshme në vit gjenden tek Pasqyra e Ngarkesave për Operim të Sistemit dhe Ngarkesave për Operim të Tregut, publikuar për industrinë para vitit të vlefshëm për atë vit. Asnjë Ngarkesë e Përdorimit të Sistemit të Transmisionit nuk paguhet në lidhje me Kapacitetin maksimal Importues të Gjeneratorit të specifikuar tek Appendix D, e as për energjinë e importuar nga sistemi.

Section 20.3. KOSTT-i i dorëzon Gjeneratorit faturën mujore ku specifikohet pagesa e vëefshme për Ngarkesën e Operimit të Sistemit dhe Ngarkesën e Operimit të Tregut, paralelisht me faturat tjera mujore që lëshohen nga KOSTT-i për Gjeneratorin.

Section 20.4. Gjeneratori detyrohet të bëjë pagesat mujore, siç specifikohen në faturat relevante mujore, brenda afateve kohore të specifikuara në procedurat e Barazimit të paraqitura në kuadër të Rregullave të Tregut (qoftë nëse Gjeneratori merr pjesë në atë treg apo jo). Pagesat bëhen në mënyrë elektronike.

Section 20.5. Dështimi i Gjeneratorit që të paguajë brenda periudhës së caktuar i jep të drejtë KOSTT-it që të parashtojë kërkesë që duhet zgjidhur sipas Section 8. Pagesat e vonuara për KOSTT-in i nënshtrohen kamatave plotësuese me Normën e Pagesës së vonuar.

Section 20.6. Nëse Gjeneratori fiton të drejtën e rimbursimit nga pagesa e tepërt apo kontesti i Ngarkesës së Operimit të Sistemit dhe Ngarkesës së Operimit të Tregut, atëherë shuma e rimbursimit

duhet të përfshijë edhe kamatën me Normë të Pagesës së vonuar ndërmjet datës kur Gjeneratori ka ngritur kontestin ose ka bërë pagesën e tepërt, si dhe datës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Section 21. Autorizimi.

Section 21.1. Kjo Marrëveshje lidhet ndërmjet Operatorit të Sistemit, Transmisionit Dhe Tregut – KOSTT, SH.A. Dhe ContourGlobal Terra 6 s.à r.l. nga përfaqësuesit vijues të kompanive.

**Operator Sistemi, Transmisioni
Dhe Tregu – KOSTT, SH.A**

ContourGlobal Terra 6 s.à r.l.

Nënshkrues: _____

Nënshkrues: _____

Pozita: _____

Pozita: _____

Appendix A Asetet e Kyçjes dhe Asetet e Përforcimit Infrastrukturalor që duhen ndërtuar apo modifikuar.

[Pikat e mëposhtme duhen ndryshuar pas Datës Efektive siç parashihet tek Section 13.1. Asetet specifike që duhen instaluar do të identifikohen me përfundimin e studimeve.]

Aseti i Transmisionit	Përgjegjësia për Ndërtim		Përgjegjësia për marrjen e Pëlqimit / Data e Pritur		Lloji i Asetit		
	Gjeneratori	KOSTT	Përgje.	Data	Asetet e Kyçjes së Gjeneratorit	KOSTT Asetet e Kyçjes	Asetet e Përforcimit Infrastrukturalor
Transformatori Step-Up i Gjeneratorit	P		Gjeneratori				
Transformatori Start-Up i Termocentralit	P		Gjeneratori				
Linja 400 kV Lartpërçuese apo kablo nëntokësore për mbështetje ndihmëse	P		Gjeneratori				
Linjë Ajrore 220 kV ose kablo nëntokësore	P		Gjeneratori				
Zgjatimi i Nënstacionit afër Nënstacionit Kosova B, duke përfshirë transformatorët e fuqisë	P		Gjeneratori				
Pajisjet e nënstacionit 400 kV	P		Gjeneratori				
Pajisjet e nënstacionit 220 kV	P		Gjeneratori				
Kyçjet e energjisë, kontrollit, SCADA dhe telekomunikacionit	P		Gjeneratori				
Pajisjet e Njehsimit	P		Gjeneratori				
Pajisjet mbrojtëse	P		Gjeneratori				

			ri				
--	--	--	----	--	--	--	--

Pëlqimet e nevojshme të planifikimit dhe mjedisit:

Gjeneratori është përgjegjës për marrjen e të gjitha pëlqimeve të nevojshme sipas ligjeve të Kosovës në lidhje me ndërtimin e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural. KOSTT-i do të bëjë përpjekje komercialisht të arsyeshme (pa ndonjë obligim të pësojë shpenzime materiale, përveç pagave të rregullta të personelit të KOSTT-it, shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve rrjedhëse) për t'i ndihmuar Gjeneratorit për aq sa është arsyeshmërisht e domosdoshme në lidhje me përpjekjet e Gjeneratorit për të marrë ato pëlqime.

Kërkesat Tokësore

[Kërkesat Tokësore do të rishikohen siç parashihet tek Section 4.1. Asetet specifike që duhen instaluar do të identifikohen me përfundimin e studimeve.]

Orari i afateve (indikative) Kjo kornizë kohore është vetëm indikative, pra as Gjeneratori e as KOSTT-i nuk mbajnë përgjegjësi për mosrespektimin e orarit të afateve.

Veprimi	Afati
Data e Fillimit të Ndërtimit:	36 muaj pas Datës Efektive / 18 muaj pas Datës së Bartjes
Data e caktuar e komisionimit të Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural:	12 muaj pas Datës së Fillimit të Ndërtimit
Data e caktuar e Kyçjes:	15 muaj pas Datës së Fillimit të Ndërtimit

Appendix B Të dhënat teknike

[Këto Appendix B duhen azhurnuar pas Datës së Ekzekutimit.]

Të Dhëna të Përgjithshme për Pikën e Kycjes

Pronari	ContourGlobal Terra 6 s.à r.l.
Lokacioni	Obiliq, Kosovë
Emri	Stabilimenti TCKR
Lloji i Gjenerimit	Djegje të linjtit
Kapaciteti i gjenerimit dhe numri i gjeneratorëve	1 x 430 – 470 MW Neto, siç përcaktohet në pajtim me Tenderin (Impianti) (siç është definuar me Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë) marrë përsipër sipas Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (plus deri në 5% shtesë për periudha të caktuara e të kufizuara)
Diagrami që paraqet Numërimin dhe Nomenklaturën	<i>Diagrami do të bashkëngjitet</i>
Diagrami që paraqet pronësinë dhe kufijtë operacionalë	<i>Diagrami do të bashkëngjitet</i>
Llojet dhe normimet e pajisjeve të këmbimit	<i>Përshkrimi do të ofrohet</i>

Lista e Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastrukturore

Kategoria e Aseteve	Emri/kodi i Asetit	Përshkrimi i asetit	Data e Kyçjes së Asetit	Kostoja e asetit (Euro)
Çelësat e Qarkut				
Shkyçësit				
Këmbyesit e tokëzimit				
Transformatorët				
Pajisjet për kompensim reaktiv				
Qarqet (koka O dhe tokëzimi U)				

Të Dhënat e Përdoruesve në Sistem

TË PËRGJITHSHME	NJËSITË	SHËNO TË DHËNAT MË POSHTË
Diagrami njëpolësh	Diagrami	do të bashkëngjitet
Pajisjet për kompensim reaktiv		
Lloji i pajisjeve	Tekst	
Normimi apo spektri i punës	Mvar	
Detaje për logjikën e kontrollit automatik	Tekst	
Pika e Kyçjes dhe tensioni	Tekst/kV	
Kontributi i qarkut të shkurtër në Sistemin e Transmisionit		
Qark i shkurtër simetrik trefazor me hyrje të rrymës në momentin e avarisë	kA	
Rrymë e qarkut të shkurtër simetrik trefazor pasi që kontributi i rrymës së avarisë sub-transiente është zbutur në masë të madhe	kA	
Vlerat e rezistencës dhe reaktancës së burimit të sekuencës zero nga sistemi i përdoruesit, parë nga pika e Kyçjes në përputhje me hyrjen maksimale si më lart		
Madhësia e tensionit para avarisë, në të cilën janë kalkuluar rrymat maksimale të avarisë	kV	
Vlerat negative të rezistencës dhe reaktancës së sekuencës nga sistemi i përdoruesit parë nga pika e Kyçjes		
Vlerat e impedancës së sekuencës zero korrespondente të pi ekuivalent, në rastin kur të dhënat paraqesin ekuivalentin e sistemit të përdoruesit		
Të dhënat e transformatorit		
Normimi i transformatorit	MVA	
Norma e tensionit të transformatorit TL/TU ose TL/TM/TU	kV	
Rezistenca e sekuencës pozitive të transformatorit R1	%	
Reaktanca e sekuencës pozitive të transformatorit X1	%	
Grupi Vektor i Transformatorit		
Të dhënat e ndërrimit të kontaktit: Niveli i tensionit të kontaktit, numri i pozicioneve të kontaktit, madhësia e hapit të kontaktit		
Të dhënat e kutisë këmbëse		
Tensioni i normuar	kV	
Tensioni i punës	kV	
Rryma e normuar e ndërprerjes së qarkut të -shkurtër (3-ph)	kA	
Rryma e normuar e ndërprerjes së qarkut të -shkurtër (1-ph)	kA	
Rryma e normuar e ndërprerjes së ngarkesës - (3-ph)	kA	
Rryma e normuar e ndërprerjes së ngarkesës - (1-ph)	kA	
Rryma e normuar e krijimit të qarkut të -shkurtër (3-ph)	kA	
Rryma e normuar e krijimit të qarkut të -shkurtër (1-ph)	kA	

Detajet e Mbrojtjes

Llojet dhe atributet e Mbrojtjes	
Kryesorja e parë	
Kryesorja e dytë	
Rezervë	
Dështimi i ndërprerësit	
Sinjalizimi i mbrojtjes	
Intertripping	
Nivelet e avarive	
Rrymat hyrëse të qarkut të shkurtër	
Impedancat	
Ndërprerja në frekuencë të ulët	
Ndërprerja për tension tejet të lartë	

Appendix C Kustet teknike specifike të Pikës së Kyçjes

Kjo Appendix C paraqet të gjitha kushtet specifike teknike relevante të Pikës së Kyçjes në lidhje me asetet e transmisionit të specifikuara tek Appendix A si dhe në pajtim me kriteret e Kodit të Rrjetit.

- i. Atributet e relesë Mbrojtëse dhe Kontrollit, p.sh. Afatet e spastrimit të avarisë: siç specifikohen në Kodin e Rrjetit.
- ii. Njehsimi dhe telemetria: siç specifikohen në Kodin e Rrjetit.
- iii. Kriteret e komunikimit (operacionet dhe dispečingu): siç specifikohen në Kodin e Rrjetit.
- iv. Stabilimentet e Posaçme automatike: siç specifikohen në Kodin e Rrjetit.
- v. Aranzhimet Operacionale: siç specifikohen në Kodin e Rrjetit.
- vi. Aranzhimet e Qasjes në Pikën e Kyçjes: siç specifikohen në Kodin e Rrjetit.
- vii. Aranzhime të tjera specifike për prioritizim, operacione apo këmbim, që kërkohen për siguri apo arsye tjera: siç specifikohen në Kodin e Rrjetit..

Këto aranzhime janë përveç atyre që përshkruhen me Kodin e Kodi i Kyçjeve.

Bashkërendimi i Mbrojtjes. Gjeneratori duhet të sigurojë dhe mirëmbajë të gjitha pajisjet e domosdoshme të matjes dhe mbrojtjes (duke përfshirë CT-të, VT-të si dhe kabllot sinjalizuese) në Termocentral. Gjeneratori duhet t'i ofrojë sinjalin e duhur KOSTT-it, gjë që rezulton me rastin kur KOSTT-i aktivizon ndërprerësin e qarkut të transformatorit të gjeneratorit.

Degëzimi dhe izolimi i Sistemit: Nuk ka ndonjë kërkesë të posaçme. Megjithatë, Gjeneratori mban përgjegjësi për sigurimin e integritetit të impiantit të tij në rast se ndodh izolimi.

Rrymat hyrëse të qarkut të shkurtër: Rrymat maksimale hyrëse të qarkut të shkurtër nga sistemi kur maten në ndërprerësin e qarkut të Transformatorit të Gjenerimit nuk duhet të tejkalojnë xxx Amps, siç parashihet nga firma e pavarur inxhinierike dhe siç përcaktohet me ndikimin e sistemit të kryer në pajtim me Section 13.1.

Tokëzimi: Pështjellat “yll” i të gjithë transformatorëve step-up të njësisë gjeneruese duhen tokëzuar mirë.

Kapaciteti i ndezjes së “zezë”: Nuk nevojitet.

Detajet e njehsimit komercial

Lokacioni fizik

Pala përgjegjëse

Personi kontaktues dhe numri i telefonit

Kodi Identifikues i Pikës së Njehsimit
(MPIC)

Pika e definuar e Njehsimit (kufiri i
kyçjes)

Pika aktuale e njehsimit

Faktorët e kompensimit të humbjeve (të
korigjohen leximet nga Pika Aktuale e
njehsimit me ato që konsiderohen të jenë
në Pikën e Definuar të Njehsimit)

Lloji i njehsorit, etj.

Informata për CT

Informata për VT

Informata për regjistruarin e të dhënave

Datat e ricertifikimit të njehsorit

Numrat e telefonave për mbledhjen e të
dhënave

Vija e Llojit të Komunikimeve1

Vija e Ofruesit të Komunikimeve1

Vija e Llojit të Komunikimeve2

Vija e Ofruesit të Komunikimeve2

Bllombat e njehsorëve që përdoren dhe
lista e numrave serikë të bllombave

Appendix D Kapaciteti i Kycjes

Me kryerjen e të gjitha punimeve të transmisionit të përshkruara tek Appendix A dhe Appendix B, Termocentrali do të ketë të drejtë të gjenerojë deri tek norma maksimale e vazhdueshme, MW Neto, siç parashihet në pajtim me Tenderin (Impianti) (siç përkufizohet me Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë) marrë përsipër sipas Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë plus 10% shtesë, në të gjitha periudhat kur sistemi është i paprekur, si dhe kur ka avari të qarkut të vetëm (kriteri n-1).

Në rastin e dy apo më shumë pajisjeve të transmisionit që janë jashtë shërbimit, Termocentrali nuk mund të gjenerojë më shumë se sa udhëzohet, kohë pas kohe, nga Operatori i Sistemit të Transmisionit.

Kapaciteti Importues i Gjeneratorit

Gjeneratori mund të importojë pa ngarkesë deri në zero (0) MW nga sistemi (“**Kapaciteti Importues i Gjeneratorit**”) për qëllimet e operimit të sistemeve ndihmëse të Termocentralit. Ky import i nënshtrohet ngarkesave normale për energji elektrike, por nuk i nënshtrohet Ngarkesave për Përdorimin e Sistemit të Transmisionit.

Appendix E Ngarkesat (pagesat)

Ngarkesat e vlefshme sipas kësaj Marrëveshjeje janë si vijon:

(a) Ngarkesat e lidhura me Pikën e Kyçjes

Ngarkesa e Operatorit të Sistemit	Siç specifikohet tek Pasqyra e Ngarkesave për Operimin e Sistemit dhe Ngarkesave për Operim të Tregut
Ngarkesa e Operatorit të Sistemit	Siç specifikohet tek Pasqyra e Ngarkesave për Operimin e Sistemit dhe Ngarkesave për Operim të Tregut

(b) Tarifa e aplikimit: Paraparë me Kodin e Rrjetit

(c) Kostoja Inxhinierike

Kostoja Inxhinierike Pjesa e parë € 10,000

Kostoja Inxhinierike Pjesa e Dytë kalkuluar si 1.5% e kostove të Aseteve të Kyçjes dhe Aseteve të Përforcimit Infrastruktural (minus pjesa e parë).

Appendix F Përgjegjësia për Lokacionin e Kycjes

Secila palë do të jetë përgjegjëse për pajisjet në anën përkatëse të Pikës së Kycjes.

Appendix G Aplikimi për Kyçje

FORMULAR APLIKIMI PËR KYÇJE

I kyçuri	ContourGlobal Terra 6 s.à r.l.
Personi kontaktues	Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari i Lartë Ligjor
Informatat kontaktuese të të kyçurit	CGK_CEO@contourglobal.com CGK_GC@contourglobal.com
Nënstacioni i propozuar Lokacioni <i>Të bashkëngjitet harta e</i>	Me gjasë, nënstacioni Kosova B; megjithatë, lokacioni i saktë i nënstacionit do të përcaktohet me studimin e përshkruar në Marrëveshjen për Kyçje.
përfundimi i kërkuar data	Siç parashihet me Marrëveshje për Kyçje
A është obligimi i kyçjes I caktuar në faza <i>Të bashkëngjiten detajet e</i>	Siç parashihet me Marrëveshje për Kyçje
Tensioni i kyçjes	Tensioni nominal: 400 kV Tensioni minimal: 380 kV Tensioni maksimal: 420 kV
Lloji i lëndës djegëse	Linjiti
Nëse hidro, bashkëngjit detaje Të plota hidrologjike; nëse me erë, bashkëngjit informatat meteorologjike	n/a
Numri i propozuar i Gjeneratorëve dhe madhësive (MW) <i>Të bashkëngjitet skica e</i>	Një gjenerator me kapacitet prej 430 - 470 MW
Gjenerimi maksimal (MW)	430 – 470 MW (plus 5% kapacitet mbingarkese)
Minimumi stabil Gjenerimi (MW)	Afërsisht 30%-40% të gjenerimit maksimal
Maksimumi i prirjes MVars dhe Maksimumi i prapambetjes	Prirje: 0.90 Prapambetje: 0.85
Pala përgjegjëse Për Kyçjen	Gjeneratori

Ju lutemi të ofroni ndonjë informatë tjetër relevante që ndihmon studimin e projektimit	S'ka
Çeku i Tarifës së Aplikimit bashkëngjitur	Të pasojë ndaras

Unë, i poshtënjshkruari, konfirmoj që të gjitha informatat e dhëna si më lart janë të sakta në njohurinë time më të mirë. Unë do të konsultoj KOSTT-in për ndryshime të konsiderueshme në këto të dhëna sapo të marr njohuri për to.

Emri dhe pozita: Konsiderohet e nënshkruar me ekzekutimin e Marrëveshjes për Kyçje

Nënshkrimi: _____

Data: _____